

Seid el Kahtani

MBUROJA E MUSLIMANIT

(Dhikri i Kuranit dhe Sunetit)

Instituti Germa

Titulli në origjinal

حصن المسلم

Autor

Seid el Kahtani

Përktheu

Azem Bardhoshi

Redaktor fetar

Ismail Bardhoshi

Redaktor gjuhësor

Ilir E. Haxhiaj

Përgatitja kompjuterike dhe transliterimi

Jusuf Kastrati

Ballina

Fatlum Zeka

Botimi i parë

Shtator, 2023

Shtypi

Grafing, Prishtinë

ISBN 978-9951-9125-6-3

Ndalohet rreptësisht shitja e këtij libri!

TABELA E TRANSLITERIMIT DHE SIMBOLEVE

ﷺ	Şal-lallahu ‘alejhi we sel-lem (paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!).	
ﷻ	RađijAllahu ‘anhu (Allahu qoftë i kënaqur me të!).	
ã	Zanorja ‘a’ e gjatë.	
ĩ	Zanorja ‘i’ e gjatë.	
ũ	Zanorja ‘u’ e gjatë.	
‘a	ع	Shqiptohet si <i>a</i> e rëndë, duke shtrënguar fytin.
‘u	ع	Shqiptohet si <i>u</i> e rëndë, duke shtrënguar fytin.
‘i	ع	Shqiptohet si <i>i</i> e rëndë, duke shtrënguar fytin.
‘ë	ع	Shqiptohet si <i>ë</i> e rëndë, duke shtrënguar fytin.
‘	ء	Shqiptohet si gjysmë ë-je (hemzeja).
đ	ض	Shqiptohet si <i>d</i> e rëndë.
đh	ظ	Shqiptohet si <i>dh</i> e rëndë.
ġ	غ	Shqiptohet si <i>g</i> me grithje.
ħ	ح	Shqiptohet si <i>h</i> e rëndë, duke shtrënguar fytin.
ħ	خ	Shqiptohet si <i>h</i> e rëndë, me grithje.
ķ	ق	Shqiptohet si <i>k</i> e rëndë.
ş	ص	Shqiptohet si <i>s</i> e rëndë.
ţ	ط	Shqiptohet si <i>t</i> e rëndë.
w	و	Shqiptohet si <i>w</i> në anglisht.

Vini re! Shkronjat që shqiptohen njëjtë nuk i kemi vendosur në tabelë.

FJALA E REDAKTORIT FETAR

Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve. Lavdërimi dhe paqja qofshin për Muhamedin, familjen, shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Me qëllim që përkthimi dhe shpjegimi i lutjeve dhe dhikrit të jetë cilësor, kemi shfrytëzuar rregullisht librat e tefsirit, të shpjegimit të hadithit, të *garibit* dhe fjalorët e nevojshëm.

Në përkthimin e ajeteve u jemi referuar edhe përkthimeve në shqip të Kuranit të madhërishëm.

Rrallëherë kemi përfituar edhe prej ndonjë libri të përkthyer në shqip.

Poshtëshënimet a pjesët e tyre që janë midis kllapave katrore [] janë të redaktorit fetar, kurse të tjerat janë të autorit. Shpeshherë në poshtëshënimet e autorit ku përmenden burimet e hadithit janë bërë dhe shkurtime, të cilat mendojmë se nuk kanë ndonjë interes të madh për lexuesin shqiptar.

Në fund, e lusim Allahun që ta bëjë të dobishme këtë punë!

HYRJA E AUTORIT

Lavdia i takon Allahut, Atij i bëjmë lavdi, Atij i kërkojmë ndihmë dhe falje. I mbështetemi Allahut të na mbrojë prej të këqijave të vetes sonë dhe të këqijave të veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb, dhe atë që e humb, nuk ka kush që ta udhëzojë.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut! I Vetëm është Allahu dhe pa shok. Dëshmoj se Muhamedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij. Salavati (Lavdërimi) i Allahut qoftë mbi Muhamedin, familjen, shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre me përsosuri në besim e në vepra, deri në Ditën e Gjykimit. Mbi ta qofshin edhe selamet e shumta.

Libërthi që keni në dorë është një variant i shkurtuar i librit tjetër me titull *“Dhikri, duatë dhe mjekimet me rukjet e Kuranit dhe të Sunetit”*, ku kam përmbledhur vetëm pjesën e dhikrit, me qëllim që të jetë një doracak më praktik.

Këtu kam përmendur vetëm formulën e dhikrit, e po ashtu e kam parë të mjaftueshme të përmend vetëm një ose dy nga burimet e hadithit, të cilat janë shënuar te varianti më i zgjeruar i librit. Kush dëshiron të njohë sahabiun që transmeton hadithin, si dhe më shumë hollësira mbi burimet origjinale të hadithit, le t'i referohet origjinalit të këtij libri.

E lus Allahun e Lartmadhërishëm, me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta, që ta bëjë këtë punim të singertë për Të, ta bëjë të dobishëm për mua në jetën e kësaj bote dhe pas vdekjes, por edhe për këdo tjetër që e lexon ose e boton, ose bëhet shkak për shpërndarjen e tij, sepse Allahu i Lartësuar ka fuqi për t'i bërë këto.

Salavatet dhe selami i Allahut qofshin për Pejgamberin tonë, Muhamedin, familjen, shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin udhën e tyre me përsosuri në besim e në vepra deri në Ditën e Gjykimit.

VLERA E PËRMENDJES SË ALLAHUT

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

﴿فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ وَاشْكُرُوا لِي وَلَا تَكْفُرُونَ﴾

“Prandaj më kujtoni Mua, që Unë t’ju kujtoj ju. Më falënderoni e mos i mohoni mirësitë e Mia.”¹

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا كَثِيرًا﴾

“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun.”²

﴿وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُم مَّغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا﴾

“Ata që i bëjnë shumë dhikër Allahut³ dhe ato që i bëjnë shumë dhikër Atij, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”⁴

﴿وَادْكُرْ رَبَّكَ فِي نَفْسِكَ تَضَرُّعًا وَخِيفَةً وَدُونَ الْجَهْرِ مِنَ الْقَوْلِ بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ وَلَا تَكُن مِّنَ الْغَافِلِينَ﴾

“Përmende Zotin tënd me vete, i përlur dhe me frikë - jo me zë të lartë, - në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që janë të shkujdesur.”⁵

¹Bekare: 152.

²Ahzab: 41.

³[Fjala ‘dhikër’ do të thotë: të përmendësh Allahun. Shprehja ‘bëjmë dhikër’ do të thotë: përmendim Allahun e Lartësuar. Te dhikri hyn edhe lutja dhe istigfari (kërkimi i faljes)].

⁴Ahzab: 35.

⁵Araf: 205.

Ndërsa Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Shembulli i atij që e përmend Zotin e tij dhe atij që nuk e përmend Zotin e tij, është si shembulli i të gjallit me të vdekurin.”*⁶

“A t’ju tregoj punën më të mirë që ju mund të bëni, që ju quhet më e pastër e më e begatë te Zoti juaj, që ju ngre më lart në gradat tuaja në Xhenet, që është më e mirë për ju sesa të shpenzoni arin dhe argjendin në rrugë të Allahut dhe më e mirë sesa të përlesheni në luftë me armikun e kështu t’i vrisni dhe t’ju vrasin?” Ata thanë: *“Po si jo”*. Pejgamberi ﷺ tha: *“Të përmendësh Allahun e Lartësuar.”*⁷

*“Allahu i Lartësuar thotë: ‘Unë do të sillem me robin Tim ashtu si mendon ai se do të veproj me të. Unë jam me të (me mëshirën, ndihmën dhe suksesin që i jap) kur ai më përmend. Nëse ai më përmend në vetvete, Unë e përmend në Vetvete. Nëse ai më përmend në një grup, Unë e përmend në një grup më të mirë (te melekët e afruar tek Ai). Nëse ai afrohet tek Unë një pëllëmbë, Unë afrohem drejt tij një kut (sa një parakrah). Nëse ai afrohet tek Unë një kut, Unë afrohem drejt tij një pash. Nëse ai vjen tek Unë duke ecur, Unë do të shkoj drejt tij me nxitim.’”*⁸

Abdullah ibn Busri tregon se një burrë tha njëherë: *“O i Dërguari i Allahut, punët (nafile) të islamit më janë bërë shumë (dhe nuk kam mundësi t’i kryej). Ndaj, më trego diçka me shpërblim të*

⁶Buhariu dhe Muslimi, por ky i fundit e sjell me këto fjalë: *“Shtëpia në të cilën përmendet Allahu dhe shtëpia në të cilën nuk përmendet Allahu është si shembulli i të gjallit me të vdekurin”*.

⁷Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe (Sahih Tirmidhi).

⁸Buhariu dhe Muslimi.

madh që të merrem me të.” Pejgamberi ﷺ i tha: “Mbaje gjuhën vazhdimisht të njomë me dhikrin e Allahut.”⁹

Pejgamberi ﷺ, po ashtu, ka thënë: “Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, do të fitojë një sevap. E një sevap shpërblehet me dhjetëfishin e tij. Nuk po ju them se “elif, lam, mim” bashkë llogariten si një shkronjë, por “elif” llogaritet një shkronjë, “lam” një shkronjë dhe “mim” një shkronjë më vete.”¹⁰

Ukbe ibn Amiri رضى الله عنه tregon se, njëherë, kur i Dërguari i Allahut ﷺ doli, ne ishim në Suffe¹¹. Ai tha: “Cili prej jush dëshiron të shkojë herët çdo ditë në But’han ose në Akik¹² e të sjellë prej andej dy deve me gunga të mëdha, jo në mënyrë të paligjshme (si me vjedhje, plaçkitje etj.) dhe as duke cënuar lidhjet farefisnore?” Ne i thamë: “Të gjithë e pëlqejmë këtë gjë, o i Dërguari i Allahut.”

Pejgamberi ﷺ tha: “Të shkoni në xhami e të mësoni ose lexoni dy ajete prej Librit të Allahut të Lartësuar, është më e mirë për ju se dy deve. Po ashtu, tri ajete janë më mirë se tri deve, katër ajete janë më mirë se katër deve; e kështu, çdo ajet më tepër që mësoni apo lexoni është më mirë se çdo deve më tepër.”¹³

Gjithashtu Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“Kushdo që ulet diku dhe nuk përmend Allahun aty, Allahu do të bëjë që, për shkak të kësaj shkujdesjeje, të dëshpërohet; dhe

⁹Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe (Sahih Tirmidhi).

¹⁰Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

¹¹[Suffa ka qenë një strehë nën hije, në xhaminë e Pejgamberit ﷺ, ku strehoheshin të varfërit që nuk kishin ku të banonin].

¹²[But’han dhe Akik ishin emra luginash në afërsi të Medines].

¹³Muslimi.

kushdo që shtrihet diku dhe nuk e përmend Allahun aty, Allahu do të bëjë që të dëshpërohet”.¹⁴ “Nëse disa njerëz ulen në një tubim dhe nuk e përmendin Allahun aty e as bëjnë salavatë për Pejgamberin ﷺ, Allahu do të bëjë që të dëshpërohen. E kështu, nëse Allahu dëshiron, i dënon, e nëse dëshiron, i fal.”¹⁵

“Ata njerëz që ngrihen nga një kuvend pa përmendur Allahun aty, ngrihen njësoj si nga një vend ku ka kërmë gomari dhe, do të pendohen në Ditën e Gjykimit.”¹⁶

¹⁴Ebu Davudi (Sahihul Xhami).

¹⁵Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

¹⁶Ebu Davudi dhe Ahmedi (Sahihul Xhami).

1-DHIKRI SAPO ZGJOHEMI NGA GJUMI

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَحْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا، وَإِلَيْهِ التَّشَوُّرُ.

Elhamdu lil-lāhil-ledhī ahjānā ba'ēde mā emātenā we ilejhin-nushūr.

(Lavdia i takon Allahut, i Cili na ngjalli pasi na vdiq¹⁷ dhe si të ringjallemi tek Ai do të tubohemi).¹⁸

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،
سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ
الْعَظِيمِ، رَبِّ اغْفِرْ لِي.

Lā ilāhe il-lāh-il-lāhu waḥdehu lā sherīke lehu, lekul mulku we lekul ḥamdu we huwe 'alā kul-li shej'in ḡadīr. Subḥānall-il-lāhi welḥamdu lil-lāhi we lā ilāhe il-lāh-il-lāhu wall-il-lāhu ekber we lā ḥawle we lā kuwwete il-lā bil-lāhil 'alijil 'aḡhīmi, rabbiḡfir lī.

(S'ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, Një dhe të Pashoq. Vetëm Atij i përket sundimi dhe lavdia, dhe Ai është i Fuqishëm për çdo gjë! I Lartësuar dhe i Pastër është Allahu nga të metat! Lavdia i takon Allahut! S'ka të adhurar me të drejtë veç Tij! Allahu është më i madhi! S'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe

¹⁷[D.m.th.: na ktheu gjallërinë, fuqinë dhe lëvizjen pasi na e pati marrë nëpërmjet gjumit. Gjumi konsiderohet njëfarë vdekjeje, një vdekje e vogël. Në këtë kuptim edhe zgjimi nga gjumi konsiderohet ngjallje].

¹⁸Buhariu dhe Muslimi

nuk ka fuqi për diçka veçse me vullnetin e Allahut, të Lartit, Madhështorit! O Zoti im, më fal!).¹⁹

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَافَانِي فِي جَسَدِي، وَزَدَ عَلَيَّ رُوحِي، وَأَذِنَ لِي بِذِكْرِهِ.

Elḥamdu lil-lāhil-ledhī ‘āfānī fī xhesedī we radde ‘alejje rūḥī we edhine lī bi dhikrihi.

(Lavdia i takon Allahut, i Cili më dha shëndet në trup, ma ktheu shpirtin²⁰ dhe më mundësoi ta përmend Atë).²¹

﴿إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لَآيَاتٍ لِأُولِي الْأَلْبَابِ * الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَامًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا سُبْحَانَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ * رَبَّنَا إِنَّكَ مِنْ تُدْخِلِ النَّارَ فَقَدْ أَخْزَيْتَهُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ * رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَقَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ * رَبَّنَا وَآتِنَا مَا وَعَدْتَنَا عَلَىٰ رُسُلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ * فَاسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أَضِيعُ عَمَلٌ عَامِلٍ مِّنْكُمْ مِّمَّنْ ذَكَرَ أَوْ أَنْتَىٰ بَعْضُكُم مِّنْ بَعْضٍ فَالَّذِينَ هَاجَرُوا وَأُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأُودُوا فِي سَبِيلِي وَقَاتَلُوا وَقُتِلُوا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَأُدْخِلَنَّهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ثَوَابًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ وَاللَّهُ عِنْدَهُ حُسْنُ الثَّوَابِ

¹⁹Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Kush e bën këtë dhikër, i falen gjynahet, dhe nëse bën donjë lutje tjetër, lutja i pranohet. Nëse merr abdes dhe fal namaz, namazi i pranohet.” Buhariu.

²⁰ [D.m.th.: na e ktheu shpirtin pasi e pati marrë gjatë gjumit. Gjatë gjumit bëhet njëfarë marrje dhe shkëputje e shpirtit nga trupi, por jo e plotë si në rastin e vdekjes. Kjo është dhe arsyeja pse në thëniet e Profetit ﷺ gjumi quhet “vdekje” dhe zgjimi prej tij quhet “ngjallje”].

²¹Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

* لَا يَغْرُنْكَ تَقَلُّبُ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي الْبِلَادِ * مَتَاعٌ قَلِيلٌ ثُمَّ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَبِئْسَ الْمِهَادُ
 * لَكِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا رَبَّهُمْ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا نُزُلًا مِّنْ عِنْدِ
 اللَّهِ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ لِلْأَبْرَارِ * وَإِنَّ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَمَن يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ
 وَمَا أُنزِلَ إِلَيْهِمْ خَاشِعِينَ لِلَّهِ لَا يَشْتَرُونَ بَيِّنَاتِ اللَّهِ تَمَنَّا قَلِيلًا أُولَئِكَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ
 رَبِّهِمْ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ * يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اصْبِرُوا وَصَابِرُوا وَرَابِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ
 لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿

(Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto – I dëlirë je Ti nga çdo e metë! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i Zjarrit. O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në Zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi. O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: “Besoni Zotin tuaj!” Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët! O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!” Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: “Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.” Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga

bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend! Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej Allahut.)

Dhe ajo që është tek Allahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë. Midis ithtarëve të Librit, me siguri ka të atillë që e besojnë Allahun dhe atë që ju është shpallur juve, si dhe atë që u është shpallur atyre, duke qenë të përlulur para Allahut dhe pa i këmbyer shpalljet e Tij me ndonjë vlerë të paktë. Ata do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Vërtet, Allahu është i shpejtë në llogari! O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!).²²

2-KUR VESH RROBËN

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَسَانِي هَذَا الثَّوْبَ وَرَزَقْنِيهِ مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي وَلَا قُوَّةَ.

Elḥamdu lil-lāhil-ledhī kesānī ḥādhā (eth-thewbe) we razekaṇīhi min ġajri ḥawlin minnī we lā kuwweh.

(Lavdia i takon Allahut, i Cili më mundësoi të vesh këtë rrobë dhe më furnizoi me të, pa lëvizje dhe pa fuqi nga ana ime).²³

²²Ajetet janë nga surja Ali Imran: 190-200. Buhariu dhe Muslimi.

²³Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe. Albani e vlerëson si hadith të mirë. [Njeriu nuk bën dot asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për asnjë veprim përveç nëse do Allahu].

3-KUR VESH NJË RROBË TË RE

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ كَسَوْتَنِيهِ، أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِهِ وَخَيْرِ مَا صُنِعَ لَهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهِ وَشَرِّ مَا صُنِعَ لَهُ.

All-Ilāhumme lekel-ḥamdu Ente kesewtenīhi, es'eluke min hajrihi we ḥajri ma ṣuni'a lehu, we e'ūdhu bike min sherrihi we sherri mā ṣuni'a lehu.

(O Allah! Ty të takon lavdia! Ti më bëre rrizk këtë veshje. Të kërkoj të ma bësh të dobishme dhe të më mundësosh përdorimin e saj në të mirën për të cilën është prodhuar! Kërkoj të më mbrosh nga sherri²⁴ i saj dhe nga përdorimi i saj për gjynahe!).²⁵

4-LUTJA PËR DIKË TJETËR, QË KA VESHUR NJË RROBË TË RE

تُبْلِي وَيُخْلِفُ اللَّهُ تَعَالَى.

Tubli we juḥlifull-ilāhu te'ālā.

(Allahu të dhëntë jetëgjatësi në të mirë), që kjo rrobë të vjetërohet dhe të ta zëvendësojë Allahu i Lartësuar me të tjera)²⁶.

الْبَسَ جَدِيدًا وَعَشَ حَمِيدًا وَمُتَ شَهِيدًا.

Ilbis xhedīden, we 'ish ḥamīden, we mut shehīden.

(Veshç gjithmonë të reja, jetofsh i nderuar dhe vdeksh si dëshmor!).²⁷

²⁴[Roba është e dëmshme për përdoruesin, për shembull, kur është haram, e papastër, e dobët ose shkak për vetëpëlqim, mburrje etj.].

²⁵Ebu Davudi (Muhtesar Shemail).

²⁶Ebu Davudi (Sahih Ebu Davud).

5-KUR ZHVESH RROBAT

بِسْمِ اللَّهِ

Bismil-lāh.

(Me emrin e Allahut).

6-KUR HYN NË TUALET

بِسْمِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخُبْثِ وَالْخَبَائِثِ.

Bismil-lāh, All-llāhumme innī e’ūdhu bike minel-ħubuthi wel-ħabāith.

(Me emrin e Allahut. O Allah! Të lutem më mbroj nga shejtanët dhe shejtanet!).²⁸

7-KUR DEL NGA TUALETI

غُفْرَانَكَ.

Ğufrāneke.

(Kërkoj faljen Tënde, o Zot!).²⁹

²⁷Ibn Maxhe (Sahih Ibn Maxhe).

²⁸Buhariu dhe Muslimi.

²⁹Tirmidhiu (Sahih Sunen Ebi Davud).

8-DHIKRI PARA SE TË MARRËSH ABDES

بِسْمِ اللَّهِ

Bismil-ilāh.

(Me emrin e Allahut).³⁰

9-DHIKRI PAS MBARIMIT TË ABDESIT

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ.

Eshhedu en lā ilāhe il-lā il-lāhu waḥdehu lā sherīke lehu, we eshhedu enne Muḥammeden ‘abduhu we rasūluhu.

(Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut Një, i Vetëm dhe i Pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij).³¹

اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَّابِينَ وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ.

All-ilāhumme xh’alnī minet-tewwābīne wexh’alnī minel mutetahhīrīn.

(O Allah! Më bëj prej atyre që pendohen dhe më bëj prej atyre që pastrohen!).³²

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ.

Subḥānekall-ilāhumme we biḥamdike, eshhedu en lā ilāhe il-lā Ente, estaḡfiruke we etūbu ilejk!

³⁰Ebu Davudi (Irvaul Galil).

³¹Muslimi.

³²Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

(O Allah, Ti je pa të meta. Lartësoj lavdinë Tënde! Dëshmoj se nuk ka të adhuroar me të drejtë përveç Teje! Ty të kërkoj falje për gjynahet dhe te Ti kthehem me pendim!).³³

10-DHIKRI KUR DEL NGA SHTËPIA

بِسْمِ اللَّهِ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ.

Bismil-lāh, tewekkeltu ‘alall-Ilāhi we lā ḥawle we lā kuwwete il-lā bil-lāh.

(Në emër të Allahut! Jam mbështetur tek Allahu! S’mund të bëhet asnjë lëvizje dhe s’ka fuqi për asgjë veçse me ndihmën e Allahut).³⁴

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَضِلَّ، أَوْ أُضَلَّ، أَوْ أَزِلَّ، أَوْ أُزَلَ، أَوْ أَظْلِمَ، أَوْ أُظْلَمَ، أَوْ أَجْهَلَ، أَوْ يُجْهَلَ عَلَيَّ.

All-Ilāhumme innī e’ūdhu bike en eḍil-le ew uḍal-le, ew ezil-le ew uzel-le, ew eḍhlime ew uḍhleme, ew exhhele ew juxhhele ‘alejje.

(O Allah! Më ruaj që të mos bie në humbje dhe të mos më çojë ndokush në humbje; që të mos gabohem dhe të mos më gabojë kush; që të mos dëmtoj ndokënd dhe të mos më dëmtojë kush; që të mos sillem keq me askënd dhe të mos sillet keq askush me mua!).³⁵

³³Nesaiu në «Amelul jeumi uel-lejli» (Irvaul Galil).

³⁴Ebu Davudi dhe Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

³⁵Katër sunenet (Sahih Tirmidhi).

11-DHIKRI KUR HYJMË NË SHTËPI

Pejgamberi ﷺ thotë: “Kur burri hyn në shtëpi, le të thotë:

بِسْمِ اللَّهِ وَجِئْنَا، وَبِسْمِ اللَّهِ خَرَجْنَا، وَعَلَى اللَّهِ رَبِّنَا تَوَكَّلْنَا.

Bismil-lāhi welexh'nā, we bismil-lāhi haraxh'nā we 'alall-ilāhi rabbinā tewekkelnā.

(Me emrin e Allahut hyjmë në shtëpi e po me emrin e Tij dalim, dhe Allahut, Zotit tonë, iu mbështetëm!”. Pastaj le t'i japë selam familjes së vet).³⁶

12-LUTJA QË THUHET KUR SHKON NË XHAMI

اللَّهُمَّ اجْعَلْ فِي قَلْبِي نُورًا، وَفِي لِسَانِي نُورًا، وَفِي سَمْعِي نُورًا، وَفِي بَصَرِي نُورًا، وَمِنْ فَوْقِي نُورًا، وَمِنْ تَحْتِي نُورًا، وَعَنْ يَمِينِي نُورًا، وَعَنْ شِمَالِي نُورًا، وَمِنْ أَمَامِي نُورًا، وَمِنْ خَلْفِي نُورًا، وَاجْعَلْ فِي نَفْسِي نُورًا، وَأَعْظِمْ لِي نُورًا، وَعَظِّمْ لِي نُورًا، وَاجْعَلْ لِي نُورًا، وَاجْعَلْنِي نُورًا، اللَّهُمَّ أَعْطِنِي نُورًا، وَاجْعَلْ فِي عَصِي نُورًا، وَفِي حَمِي نُورًا، وَفِي دَمِي نُورًا، وَفِي شَعْرِي نُورًا، وَفِي بَشْرِي نُورًا. اللَّهُمَّ اجْعَلْ لِي نُورًا فِي قَبْرِي... وَنُورًا فِي عَظَامِي، وَزِدْنِي نُورًا، وَزِدْنِي نُورًا، وَزِدْنِي نُورًا، وَهَبْ لِي نُورًا عَلَى نُورٍ.

³⁶Ebu Davudi. Sipas Ibn Bazit senedi është i mirë. Por kur hyjmë në shtëpi, themi: «Bismilah», sepse në një hadith tjetër të saktë, Pejgamberi ﷺ thotë: “Kur njeriu hyn në shtëpinë e vet dhe përmend Allahun teksa hyn dhe kur fillon ushqimin, shejtani u thotë vëllezërve, ndihmësive dhe shokëve të tij po prej shejtanëve: ‘Këtë natë nuk keni as vend për të ndenjur dhe as darkë!’» (Muslimi).

All-Ilāhummexh'al fī ḵalbī nūran, we fī lisānī nūran, we fī sem'ī nūran, we fī beṣarī nūran, we min fewḵī nūran, we min taḥṭī nūran, we 'an jemīnī nūran we 'an shimālī nūran, we min emāmī nūran, we min ḥalfī nūran, wexh'al fī nefṣī nūran, we a'ēḍhim lī nūran, we aḍh-ḍhim lī nūran, wexh'al lī nūran, wexh'alnī nūrā. All-Ilāhumme a'ēṭinī nūran, wexh'al fī 'aṣabī nūran, we fī laḥmī nūran, we fī demī nūran, we fī sha'ērī nūran, we fī besherī nūrā. All-Ilāhummexh'al lī nūran fī ḵabrī.. we nūran fī 'iḍḥāmī, we zidnī nūran. We zidnī nūran, we zidnī nūran. we heb lī nūran 'alā nūr.

(O Allah! Më jep dritë në zemër, në gjuhë, në dëgjim e në shikim. Më bëj dritë nga lart dhe nga poshtë, nga e djathta dhe nga e majta ime! Më bëj dritë nga përpara dhe nga prapa! Më bëj dritë në vetveten time! O Allah! Ma zmadho dritën! Bëj për mua dritë dhe më bëj mua dritë! O Allah më jep mua dritë dhe, bëj dritë në gilcat e mi, në mishin tim, në gjakun tim, në flokët e mia dhe në lëkurën time. “O Allah ma ndriço varrin... dhe m'i ndriço kockat.”³⁷ “Ma shto dritën, ma shto dritën, ma shto dritën”³⁸, “dhe më dhuro dritë mbi dritë!”).³⁹

³⁷Tirmidhiu.

³⁸Buhariu në Edebul Mufred (Sahih Edeb Mufred)].

³⁹Ibn Haxheri në «Fet'hul Bari» pohon se këtë shprehje e sjell Ibn Ebi Asim në «Kitabud-dua».

13-KUR HYJMË NË XHAMI

Në xhami hyjmë me këmbën e djathtë⁴⁰, duke thënë:

أَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ، وَيُوجِّهُ الْكَرِيمِ، وَسُلْطَانِهِ الْقَدِيمِ، مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

E'üdhu bil-lâhil 'aðhîm, we bi wexhhihil kerîm, we şultânihil kadîm, mineshe-shejtânir-rraxhîm.

(Kërkoj nga Allahu i Madhërishëm, me Fytyrën e Tij Fisnike dhe me fuqinë e pushtetin e Tij të përhershëm, të më mbrojnë nga shejtani i mallkuar!).⁴¹

بِسْمِ اللَّهِ، وَالصَّلَاةِ، وَالسَّلَامِ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ افْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ.

Bismil-lâh, weş-şalātu wes-selâmu 'alâ Rasûlil-lâh. All-lâhumme'ftaḥ lî ebwābe raḥmetike!

(Në emër të Allahut, salavati⁴² dhe selami i Allahut qofshin për të Dërguarin e Allahut⁴³. O Allah! Më hap dyert e mëshirës Tënde!).⁴⁴

⁴⁰Enesi ؓ tregon: “Nga suneti është që kur të hysh në xhami, të fusësh përpara këmbën e djathtë, ndërsa kur të dalësh nga xhamia, të nxjerrësh përpara këmbën e majtë”. Shënojnë Hakimi dhe Bejhakiu. Albani thotë se hadithi është i mirë.

⁴¹Ebu Davudi (Sahih Xhami).

⁴²Ibn Sunni [Hadithi është i mirë].

⁴³Ebu Davudi (Sahi Xhami). [Salavati i Allahut për të Dërguarin do të thotë që ta lavdërojë tek elita e lartë (melekët). Ndërsa selami i Allahut për të Dërguarin do të thotë që t'i japë paqe dhe ta ruajë nga të këqijat. Kështu, kur hyn në xhami, besimtari i lutet Allahut që ta lavdërojë Pejgamberin صلى الله عليه وسلم te melekët dhe t'i japë paqe e ta ruajë nga të këqijat].

⁴⁴Muslimi.

14-KUR DALIM NGA XHAMIA

Nga xhamia dalim me këmbën e majtë, duke thënë:

بِسْمِ اللَّهِ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ، اللَّهُمَّ
اغْصِنِي مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

**Bismil-lāh, weş-şalātu wes-selāmu ‘alā Rasūlil-lāh. All-
llāhumme innī es’eluke min faḍlike, All-llāhumme i’ēşimnī
minesh-shejtānirr-raxhīm.**

(Në emër të Allahut, salavati dhe selami i Allahut qofshin mbi
Muhamedin. ‘O Allah! Të lutem të më japësh nga mirësitë e Tua!’
O Allah, më mbroj nga shejtani i mallkuar!).⁴⁵

15-KUR THIRRET EZANI

1. Kur thirret ezani, përsërisim fjalët që thotë muezini, me
përrjashtim të shprehjeve *hajje ‘aleş-şalāh, hajje ‘alel felāḥ* (Eja në
namaz, eja në shpëtim), pasi në vend të tyre themi:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ.

Lā ḥawle we lā kuwwete il-lā bil-lāh.

(S’mund të bëhet asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për asgjë veçse
me ndihmën e Allahut).⁴⁶

⁴⁵Burimet e hadithit u përmendën në poshtëshënimet e mëparshme. Porse shtojcën «O Allah! më mbroj nga shejtani i mallkuar!» e sjell Ibn Maxhe (Sahih Ibn Maxhe).

⁴⁶Buhariu dhe Muslimi.

2. Menjëherë pasi muezini thotë dy shprehjet e dëshmisë “Eshhedu en lā ilāhe il-lall-Ilāh, eshhedu enne Muḥammeden Rasūlull-Ilāh”, themi:

وَأَنَا أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، رَضِيتُ بِاللَّهِ رَبًّا، وَمُحَمَّدٍ رَسُولًا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا.

We ene eshhedu en lā ilāhe il-lall-Ilāhu waḥdehu lā sherīke lehu, we enne Muḥammeden ‘abduhu we rasūluhu. Raḏītu bil-lāhi Rabben, we bi Muḥammedin rasūlen, we bil Islāmi dīnen.

(Edhe unë dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, Një dhe i Pashoq, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Allahut. Jam i kënaqur me Allahun si Zot, me Muhamedin si të Dërguar dhe me Islamin si fe).⁴⁷

3. Mbasi përsërisim shprehjet e ezanit pas muezinit bëjmë salavatë për Pejgamberin.

4. Pas salavatit themi:

اللَّهُمَّ رَبِّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ التَّامَّةِ، وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ، آتِ مُحَمَّدًا الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ، وَابْعَثْهُ مَقَامًا مُحَمَّدًا الَّذِي وَعَدْتَهُ، [إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ].

All-Ilāhumme rabbe hādhid-da’ëwetit-tāmmeh, weṣ-ṣalātil kāimeh, āti Muḥammedenil wesīlete wel faḏīlete, web’athhu meḳāmen maḥmūden el-ledhī we’adtehu [inneke lā tuḥliful-mī’ād].

(O Allah! Zoti i kësaj thirrjeje të përkryer e të pandryshueshme dhe i namazit që do të falet! Jepi Muhamedit *Uesile*-n (pozitën më

⁴⁷Muslimi.

të lartë në Xhenet) dhe *Fadile*-n (gradën e epërsisë ndaj të tëra krijesave) dhe ngrije atë në vendin e lavdishëm (ndërmjetësimin e madh në Ditën e Gjykimit). [Vërtet, Ti nuk e shkel premtimin!].⁴⁸

5. Të bëjmë lutje për vetveten ndërmjet ezanit dhe ikametit, pasi lutja në këtë kohë pranohet.⁴⁹

16-LUTJA PAS TEKBITIT FILLESTAR, KUR HAPIM NAMAZIN

اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنْ خَطَايَايَ كَمَا يُنَقَّى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْنِي مِنْ خَطَايَايَ، بِالثَّلْجِ وَالْمَاءِ وَالْبَرَدِ.

All-Ilāhumme bā'id bejnī we bejne ḥaṭājjāje kemā bā'adte bejnel meshriki wel mağrib! All-Ilāhumme neḳḳinī min ḥaṭājjāje kemā juneḳḳath-thewbul ebejdu mined-denes! All-Ilāhummeğsilnī min ḥaṭājjāje bith-thelxhi wel māi wel berad.

(O Allah, largomë prej gjynaheve, ashtu siç ke larguar lindjen prej perëndimit! O Allah, pastromë prej gjynaheve, ashtu siç pastrohen rrobat e bardha prej ndyrësisë! O Allah, pastromë prej gjynaheve me borë, ujë dhe breshër!).⁵⁰

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، وَتَبَارَكَ اسْمُكَ، وَتَعَالَى جَدُّكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ.

Subḥānekall-Ilāhumme we bihamdike we tebārikesmuke, we te'ālā xhedduke, we lā ilāhe gajruke.

⁴⁸Buhariu, porse shtojcën në kllapat katrore e shënon vetëm Bejhakui. Për këtë shtojcë Ibn Bazi në «Tuhfetul Ahjar» thotë se ka sened të mirë.

⁴⁹Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ahmedi (Irvaul Galil).

⁵⁰Buhariu dhe Muslimi.

(O Allah! Ti je pa të meta. Ty të bëj lavdi! Emri Yt është i bekuar, Madhëria jote është e Lartësuar, dhe askush pos Teje s'ka të drejtë të adhurohet!).⁵¹

وَجْهَتْ وَجْهِي لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ، إِنَّ صَلَاتِي، وَنُسُكِي، وَمَحْيَايَ، وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ. اللَّهُمَّ أَنْتَ الْمَلِكُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَنْتَ رَبِّي وَأَنَا عَبْدُكَ، ظَلَمْتُ نَفْسِي وَاعْتَرَفْتُ بِذُنُوبِي فَأَعْفِرْ لِي ذُنُوبِي جَمِيعًا إِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ. وَاهْدِنِي لِأَحْسَنِ الْأَخْلَاقِ لَا يَهْدِي لِأَحْسَنِهَا إِلَّا أَنْتَ، وَاصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا، لَا يَصْرِفُ عَنِّي سَيِّئَهَا إِلَّا أَنْتَ، لَبَّيْكَ وَسَعْدَيْكَ، وَالْخَيْرُ كُلُّهُ بِيَدَيْكَ، وَالشَّرُّ لَيْسَ إِلَيْكَ، أَنَا بِكَ وَإِلَيْكَ، تَبَارَكْتَ وَتَعَالَيْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ.

Wexhxhehtu wexhhije lil-ledhĩ fețaras-semăwăti wel erđa ħanĩfen we mă ene minel mushrikĩne. Inne řalătĩ we nusukĩ we maĥjăje we memătĩ lil-lăhi Rabbil ‘ălemin, lă sherĩke lehu, we bi dhălike umirtu we ene minel muslimĩn. All-ilăhumme Entel Meliku lă ilăhe il-lă Ente. Ente Rabbĩ we ene ‘abduke. Đhalemtu nefsĩ we’ëteraftu bi dhenbĩ feğfir lĩ dhunũbĩ xhemĩ’an innehu lă jağfirudh-dhunũbe il-lă Ente! Wehdinĩ li aĥsenil ahlăqi, lă jehďĩ li aĥsenihă il-lă Ente, weřif ‘annĩ sejjiehă lă jeřifu ‘annĩ sejjiehă il-lă Ente! Lebbejke we sa’ëdejke wel ĥajru kul-luhu bi jedejke wesh-sherru lejse ilejke. Ene bike we ilejke, tebărakte we te’ălejte. Estagfiruke we etũbu ilejke.

(Kam kthyer fytyrën drejt Krijuesit të qiejve dhe të tokës i dëlirë nga idhujtaria, e unë nuk jam prej idhujtarëve! Vërtet,

⁵¹Ebu Davudi (Sahih Tirmidhi).

namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e Botëve, i Cili nuk ka shok. Me këtë jam urdhëruar dhe unë jam prej muslimanëve. O Allah, Ti je Sunduesi! Askush nuk ka të drejtë të adhurohet pos Teje! Ti je Zoti im dhe unë jam robi Yt! Unë i kam bërë dëm vetes dhe i kam pranuar gjynahet e mia. Prandaj, m' i fal të gjitha gjynahet e mia, sepse askush tjetër nuk i fal gjynahet veç Teje! Më udhëzo në sjelljen më të mirë, në të cilën nuk mund të udhëzojë askush veç Teje, dhe më ruaj nga sjellja e keqe, nga e cila nuk mund të më ruajë askush veç Teje! Vazhdimisht kam për të respektuar urdhërat e Tu dhe pareshtur do të përkrah e do të pasoj fenë Tënde! E gjithë e mira është në duart e Tua, ndërsa e keqja nuk të përket Ty! Unë të mbështetem vetëm Ty, të përkas vetëm Ty dhe vetëm Ti më jep mbarësi! Ti je i Bekuar dhe i Lartësuar! Kërkoj faljen Tënde dhe pendohem para Teje!).⁵²

اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرَائِيلَ، وَمِيكَائِيلَ، وَإِسْرَافِيلَ، فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ. اهْدِنِي لِمَا اخْتَلَفَ فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ إِنَّكَ تَهْدِي مَنْ تَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ.

All-Ilāhumme Rabbe Xhibrāīle we Mīkāīle we Isrāfīle, Fātiras-semāwāti wel erḍi, ‘ālimel ġajbi wesh-shehādeti, Ente taḥkumu bejne ‘ibādike fīmā kānū fihi jahtelifūn. Ihdinī limeḥtulife fihi minel ḥaḳḳi bi idhnike! Inneke tehdī men teshāu ilā širāṭin musteḳīm.

(O Allah! Zot i Xhibrilit, Mikailit dhe Israfilit! Krijues i qiejve dhe i tokës! Njohës i së fshehtës dhe i së dukshmes! Ti je Ai që do të

⁵²Muslimi.

gjykosht mes robërve të Tu për çështjet që ata nuk pajtoheshin!
Më udhëzo me Mëshirën Tënde, në të vërtetën, në çështjet ku
njerëzit janë në kundërshtim, sepse, vërtet Ti e udhëzon kë të
duash në Rugën e Drejtë!).⁵³

اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا،
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَسُبْحَانَ اللَّهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا (ثلاثا)، أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ: مِنْ
نَفْسِهِ، وَنَفْسِهِ، وَهَمَزِهِ.

**Allāhu ekberu kebīrā, Allāhu ekberu kebīrā, Allāhu ekberu
kebīrā, welḥamdu lil-lāhi kethīrā, welḥamdu lil-lāhi kethīrā,
welḥamdu lil-lāhi kethīrā, we Subḥānall-Ilāhi bukraten we aṣīlā,
we Subḥānall-Ilāhi bukraten we aṣīlā, we Subḥānall-Ilāhi
bukraten we aṣīlā. E’ūdhu bil-lāhi mineshe-shejtāni: min nefhihi,
we nefthihi we hemzihi!**

(Allahu është më i Madhi, (kështu shprehem duke madhëruar
më të Madhin)! Lavdia i takon Allahut, (kështu them duke i bërë
lavdi të shumtë Allahut)! Allahu është i Dëlirë nga të metat,
(kështu lartësoj Allahun) çdo mëngjes e çdo pasdite! I lutem
Allahut të më ruajë nga shejtani i mallkuar; nga arroganca, vargjet
poetike të këqija dhe epilepsia, të cilat nxiten ose shkaktohen prej
tij!).⁵⁴

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ، أَنْتَ نُورُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قَيِّمُ
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ،
وَلَكَ الْحَمْدُ لَكَ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مَلِكُ

⁵³Muslimi.

⁵⁴Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Ahmedî (Sahih kelim tajjib).

السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، وَلَكَ الْحَمْدُ، أَنْتَ الْحَقُّ، وَوَعْدُكَ الْحَقُّ، وَقَوْلُكَ الْحَقُّ، وَلِقَاؤُكَ الْحَقُّ، وَاجْتِنَةُ حَقٍّ، وَالتَّارُ حَقٌّ، وَالتَّبَيُّونَ حَقٌّ، وَمَحَمَّدٌ (صلى الله عليه و سلم) حَقٌّ، وَالسَّاعَةُ حَقٌّ، اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَإِلَيْكَ أَنْبْتُ، وَبِكَ خَاصَمْتُ، وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ. فَاعْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ، وَمَا أَخَّرْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ، وَمَا أَعْلَنْتُ، وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي، أَنْتَ الْمُقَدِّمُ، وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَنْتَ إِلَهِي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ.

All-Ilāhumme lekel-ḥamdu Ente Nūrus-semāwāti wel erḍi we men fihinne, we lekel-ḥamdu Ente ʔajjimūsem-semāwāti wel erḍi, we men fihinne, we lekel-ḥamdu Ente Rabus-semāwāti wel erḍi, we men fihinne, we lekel-ḥamdu leke mulkus-semāwāti wel erḍi, we men fihinne, we lekel-ḥamdu Ente melikus-semāwāti wel erḍi, we lekel-ḥamdu Entel ḥaḳḳu, we wa’ēdukel ḥaḳḳu we ʔawlukel ḥaḳḳu, we liḳāukel ḥaḳḳu, wel xhennetu ḥaḳḳun, wen-nāru ḥaḳḳun, wen-nebijjūne ḥaḳḳun, we Muḥammedun (ṣallallāhu ‘alejhi we sel-leme) ḥaḳḳun, wes-sā’atu ḥaḳḳun. All-Ilāhumme leke eslemtu, we ‘alejke tewekkeltu, we bike āmentu, we ilejke enebtu, we bike ḥāṣamtu we ilejke ḥākemtu. Feḡfir lī mā ʔaddemtu we mā aḥḥartu, we mā esrartu we mā a’ēlentu, we mā Ente a’ēlemu bihi minnī. Entel Muḳaddimu we Entel Mueḥḥiru, lā ilāhe il-lā Ent. Ente Ilāhī, lā Ilāhe il-lā Ente, we lā ḥawle we lā ḳuwwete il-lā bil-lāh.

(O Allah, Ty të takon lavdia! Ti je ndriçuesi i qiejve dhe i tokës e çfarë ka mes tyre! Ty të takon lavdia! Ti je mbajtësi i qiejve dhe i Tokës e çfarë ka mes tyre! Ty të takon lavdia! Ti je Zoti i qiejve dhe i Tokës e çfarë ka mes tyre! Ty të takon lavdia! Ty të përket sundimi i qiejve dhe i Tokës e çfarë ka mes tyre! Ty të takon lavdia!

Ti je Sunduesi i qiejve dhe i Tokës! Ty të takon lavdia! Ti je i Vërteti. Premtimi Yt është realitet, fjala Jote është e vërtetë, takimi me ty është i vërtetë, Xheneti është realitet, Zjarri është realitet, *nebijjin-ët* (profetët) janë vërtet lajmëtarë nga Allahu për njerëzit, Muhamedi ﷺ është vërtet i Dërguari i Allahut, Dita e Gjykimit është realitet! O Allah, Ty të jam dorëzuar, tek Ti jam mbështetur, tek Ti kam besuar, i jam kthyer adhurimit ndaj Teje, me fuqinë dhe argumentet që më ke dhënë Ti u kundërvihem atyre që të mohojnë Ty dhe nuk i pranojnë të vërtetat që vijnë prej Teje. Ty të drejtohem për të gjykuar mes meje dhe mes atyre që s'e pranojnë të vërtetën! M'i fal gjynahet e mëparshme dhe të tashmet, ato që kam fshehur e ato që kam bërë haptazi, por edhe ato që Ti i di më mirë se unë. Ti ngre e afron kë të duash, duke ia bërë mbarë të bëjë ibadete dhe, me urtësinë Tënde, largon kë të duash, duke mos e ndihmuar për diçka të tillë! Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Teje! Ti je Zoti im e s'ka Zot tjetër veç Teje! S'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe s'ka fuqi ndryshe, veçse me vullnetin e Allahut)⁵⁵.

⁵⁵Buhariu në disa vende në «Sahih» dhe Muslimi, por varianti që sjell Muslimi është më i shkurtër. Këtë lutje Profeti ﷺ e thoshte kur niste namazin e natës.

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ.

Subhāne rabbijel ‘aḍhīm (tri herë).

(I Dëlrë nga të metat është Zoti im, i Madhërishmi!).⁵⁶

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي.

Subhānekall-Ilāhumme rabbenā we biḥamdike. All-Ilāhumeḡfir
rī.

(O Allah, Zoti ynë, Ti je i dëlrë nga të metat. Lartësoj lavdinë
Tënde. O Allah, më fal!).⁵⁷

سُبُّوحٌ، قُدُّوسٌ، رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ.

Subbūḥun Ḳuddūsun Rabbul melāiketi werr-rrūḥ.

(I Dëlrë nga të gjitha mangësitë, i Shenjtë, Zot i melekëve dhe i
Xhibrilit).⁵⁸

اللَّهُمَّ لَكَ رَكَعْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَلَكَ أَسْلَمْتُ، خَشَعَ لَكَ سَمْعِي، وَبَصَرِي، وَخَيِّي،
وَعَظْمِي، وَعَصِي، وَمَا اسْتَقَلَّتْ بِهِ قَدَمِي.

All-Ilāhumme leke raka’ētu we bike āmentu we leke eslemtu.
Hashe’a leke sem’ī we beṣarī we muḥḥi we aḍhmī we ‘aṣabī, we
mā isteḳal-let bihi ḳademī.

⁵⁶Katër sunenet dhe Ahmedi (Sahih Tirmidhi).

⁵⁷Buhariu dhe Muslimi.

⁵⁸Muslimi dhe Ebu Davudi. [Emri i Allahut ‘*Kuddus* – i Shenjtë’ ka kuptimin: i Dëlrë nga gjithçka që nuk i përshtatet madhërisë së Tij].

(O Allah! Ty të jam përlur, Ty të kam besuar, Ty të jam nënshtruar! Të përlur për Ty janë dëgjimi im, shikimi im, truri im, eshtrat e mia dhe gilcat e mia dhe [çdo gjë që mbajnë këmbët e mia]!).⁵⁹

سُبْحَانَ ذِي الْجَبُرُوتِ، وَالْمَلَكُوتِ، وَالْكِبَرِيَاءِ، وَالْعُظَمَةِ.

Subhāne dhil xheberūti wel melekūti wel kibrijāi wel aḍhameh.

(Pa të meta është Ai që nështron robërit e Vet me urdhra dhe ndalesa, që sundon çdo gjë, dhe që është më i Larti e më Madhështori).⁶⁰

18-KUR NGRIHEMI NGA RUKUJA E NAMAZIT

Duke u ngritur nga rukuja themi:

سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمَدَهُ.

Semi'all-Ilāhu limen ḥamideh!

(Allahu e pranon lavdinë e atij që i bën lavdi!).⁶¹ Kur ngrihemi plotësisht në këmbë themi:

رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ، حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ.

Rabbenā we lekel-ḥamdu ḥamden kethīran ṭajjiben mubāraken fīhi.

⁵⁹Muslimi, por pjesën në kllapa e sjell Ibn Huzejme dhe Ibn Hibani.

⁶⁰Ebu Davudi, Nisaiu dhe Ahmedi. Senedi është i mirë.

⁶¹Buhariu. Sipas një shpjegimi tjetër kuptimi del kështu: "Allahu e pranoftë lavdinë e atij që i bën lavdi (Allahut)!".

(Zoti ynë, Ty të takon lavdia, lavdi e panumërt, e dëlirë nga syfaqësia dhe e pafundme).⁶²

مِلَّةَ السَّمَوَاتِ وَمِلَّةَ الْأَرْضِ، وَمَا بَيْنَهُمَا، وَمِلَّةَ مَا شِئْتَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدُ. أَهْلَ
الْثَّنَاءِ وَالْمَجْدِ، أَحَقُّ مَا قَالَ الْعَبْدُ، وَكُنَّا لَكَ عَبْدًا. اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا
مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ.

**Mil'es-semawāti we mil'el erđi, we mā bejnehumā, we mil'e
mā shi'te min shej'in ba'ëdu. Ehleth-thenāi wel-mexhdi, eħakķu
ma ķālel 'abdu, we kul-lunā leke 'abdun. All-Ilāhumme lā māni'a
limā a'ëťajte, we lā mu'ëťije limā mena'ëte we lā jenfe'u dhel
xheddi minkel xheddu.**

(Ty të takojnë lavditë, aq lavdi sa plot qiejt, sa plot toka e ç'ka
ndërmjet tyre dhe sa plot gjithçkaje tjetër që Ti dëshiron! O i Denji
për lavde e madhështi! Fjala më e drejtë që robi thotë – dhe të
gjithë ne jemi robërit e Tu – 'Askush s'mund të ndalë atë që jep Ti,
dhe askush s'mund të japë atë që Ti e ndal; dhe të pasurit apo
njeriut me pozitë nuk mund t'i bëjë dobi tek Ti pasuria a pozita,
por i bën dobi veçse puna e mirë')⁶³.

⁶²Buhariu.

⁶³Muslimi.

19-LUTJET NË SEXHDE

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى.

Subhāne Rabbijel a’ēlā (tri herë).

(I Dëlrë nga të metat është Zoti im, më i Larti).⁶⁴

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي.

Subhānekall-Ilāhumme rabbenā we biḥamdike, All-Ilāhummeḡfir lī.

(Pa të meta je, o Allah! Zoti ynë! Ty të bëj lavdi! O Allah, më fal!).⁶⁵

سُبُّوحٌ، قُدُّوسٌ، رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ.

Subbūḥun Ḳuddūsun Rabbul melāiketi werr-rrūḥ!

(I Dëlrë nga çdo mangësi, i Shenjtë, Zoti i melekëve dhe i Xhibrilit).⁶⁶

اللَّهُمَّ لَكَ سَجَدْتُ وَبِكَ آمَنْتُ، وَلَكَ أَسْلَمْتُ، سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ، وَصَوَّرَهُ،
وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ، تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ.

All-Ilāhumme leke sexhedtu we bike āmentu we leke eslemtu. Sexhede wexhhīje lil-ledhī ḥaleḳahu we şawwerahu we sheḳḳa sem’ahu we beşarahu. Tebārakall-Ilāhu aḥsenul ḥāliḳin!

⁶⁴Katër sunenet dhe Ahmedi (Sahih Tirmidhi).

⁶⁵Buhariu dhe Muslimi.

⁶⁶Muslimi.

(O Allah! Për Ty kam bërë sexhde; Ty të kam besuar, Ty të jam nënshtruar! Fytyra ime ka rënë në sexhde për Atë i Cili e krijoi dhe e trajtësoi, e i dha aparatin e të dëgjuarit dhe aparatin e të parit! I Madhërishëm është Allahu, Krijuesi më i mirë!).⁶⁷

سُبْحَانَ ذِي الْجَبَرُوتِ، وَالْمَلَكُوتِ، وَالْكِبْرِيَاءِ، وَالْعَظَمَةِ.

Subhāne dhil xheberūti wel melekūti wel kibrijāi wel aḍhameh.

(I Dëlrë nga të metat është Ai që nështron robërit e Vet me urdhra dhe ndalesa, që sundon çdo gjë, dhe që është më i Larti e më Madhështori).⁶⁸

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي كُلَّهُ: دِقَّةً وَجِلَّةً، وَأَوَّلَهُ وَآخِرَهُ، وَعَلاَئِيَّتَهُ وَسِرَّهُ.

All-Ilāhummeḡfir lī dhenbī kul-lehu: diḡḡahu we xhil-lehu, we ewwelehu we āhirahu, we ‘alānijjetehu we sirr-rrahu!

(O Allah! M’i fal të gjitha gjynahet: të voglat dhe të mëdhatë, të parat dhe të fundit, të dukshmet dhe të fshehtat!).⁶⁹

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سَخَطِكَ، وَمِعَاْفَاتِكَ مِنْ عِقُوبَتِكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ، لَا أُحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ، أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَى نَفْسِكَ.

All-Ilāhumme innī e’ūdhu bi riḡāke min sehaṭik, we bi mu’āfātike min ‘uḡūbetik, we e’ūdhu bike minke! Lā uḡṣī thenāen ‘alejke, Ente kemā ethnejte ‘ala nefsike.

⁶⁷Muslimi.

⁶⁸Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ahmedi (Sahih Ebi Davud).

⁶⁹Muslimi.

(O Allah! Të lutem të më ruash me kënaqësinë Tënde nga hidhërimi Yt, të më ruash me faljen Tënde nga dënimi Yt! Kërkoj strehim tek Ti, për t'u mbrojtur prej Teje!⁷⁰ Unë, sado të përpiqem, nuk mund t'i numëroj dot lavdërimet e Tua, ashtu siç e meriton! Ti je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën!).⁷¹

20-LUTJA NË ULJEN NDËRMJET DY SEXHDEVE

رَبِّ اغْفِرْ لِي، رَبِّ اغْفِرْ لِي.

Rabbiḡfir lī, Rabbiḡfir lī.

(O Zoti im, më fal! O Zoti im, më fal!).⁷²

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَاجْبُرْنِي، وَعَافِنِي، وَارْزُقْنِي، وَارْفَعْنِي.

**All-Ilāhummeḡfir lī, werḡamnī, wehdinī, wexhburnī, we
‘āfinī, werzuḡnī werfa’ēnī!**

(O Allah! Më fal, më mëshiro, më udhëzo, m’i plotëso nevojat e m’i zëvendëso humbjet dhe ma ndreq gjendjen, më jep shëndet e më ruaj nga të këqijat, më furnizo me të mira, më ngre në gradë të lartë (në të dyja botët!)).⁷³

⁷⁰[Domethënë: ‘Të lutem të më mbrosh me cilësitë e Tua të mirëbërjes prej pasojave që vijnë nga cilësitë e Tua të madhështisë, plotpushtetshmërisë dhe ndëshkimit!’].

⁷¹Muslimi.

⁷²Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe (Sahih Ibn Maxhe).

⁷³Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe (Sahih Tirmidhi dhe Sahih Ibn Maxhe).

21-LUTJET QË BËHEN NË SEXHDEN E LEXIMIT TË KURANIT

سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ، وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ بِحَوْلِهِ وَقُوَّتِهِ، (فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ).

Sexhede wexhhije lil-ledhĩ ħaleķahu we sheķķa sem’ahu we beşarahu bi ħawlihĩ we ķuwwetihĩ. [Fe tebārakall-İlāhu aĥsenul ħāliķĩn!]

(Fytyra ime ka rënë në sexhde për Atë i Cili e krijoi, i dha të dëgjuarit dhe të parët e saktë, me fuqinë e Tij!! [I Madhërishëm është Allahu, Krijuesi më i mirë!])⁷⁴

اللَّهُمَّ اكْتُبْ لِي بِهَا عِنْدَكَ أَجْرًا، وَصَعْ عَنِّي بِهَا وَزْرًا، وَاجْعَلْهَا لِي عِنْدَكَ ذُخْرًا، وَتَقَبَّلْهَا مِنِّي كَمَا تَقَبَّلْتَهَا مِنْ عَبْدِكَ دَاوُدَ.

All-İlāhummeķtub lĩ biĥā ‘indeke exħran we đa’e ‘annĩ biĥā wizran wexħ’alhā lĩ ‘indeke dhuħran, we teķabbelĥā minnĩ kemā teķabbeltehā min ‘abdiķe Dāwūd.

(O Allah! Më shkruaj me të shpërblimin, më hiq për shkak të saj një gjynah, ruaje atë për mua atje tek Ti, dhe pranoma atë ashtu sikurse ia pranove robit tënd Davudit!).⁷⁵

⁷⁴Tirmidhi, Ahmedî dhe Hakimî.

⁷⁵Tirmidhiu dhe Hakimî.

22-TEHIJATI GJATË TË NDEJURIT ULUR NË NAMAZ

التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ، وَالصَّلَوَاتُ، وَالطَّيِّبَاتُ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ،
السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ. أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا
عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ.

**Et-tehijjātu lil-lāhi weş-şalewātu, weţ-ţajjibātu, es-selāmu
‘alejke ejjuhen-nebijju we raḥmetull-llāhi we berakātuḥu, es-
selāmu ‘alejnā we ‘alā ‘ibādil-lāhiş-şālihīn, eshhedu en lā ilāhe il-
lAll-llāh, we eshhedu enne Muḥammeden ‘abduḥu we rasūluḥu.**

(Nderimet, madhështimet, lutjet dhe fjalët e dëlira i takojnë Allahut!⁷⁶ Paqedhënësi (*Es Selamu*) qoftë me ty⁷⁷, o i Dërguar, dhe po ashtu mëshira dhe begatimet e vazhdueshme të Tij! Paqedhënësi qoftë me ne dhe me robërit e drejtë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka të drejtë të adhurohet kush përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij!).⁷⁸

⁷⁶[Fjalët e dëlira (et –tajibat) janë të gjitha fjalët me kuptim të dëlirë, të bukur, të përsosur, që janë të përshtatshme për lëvdimin dhe lartësimin e Allahut].

⁷⁷[Es Selam është një emër i Allahut, që do të thotë: ‘Paqedhënësi; Shpëtimtari i robërve të Tij prej të këqijave’. Kjo shprehje është sikur të thuash: ‘Allahu qoftë me ty’! Pra, ajo do të thotë: Paqedhënësi (*Es Selamu*) qoftë me ty, për të të ruajtur nga të këqijat].

⁷⁸Buhariu dhe Muslimi.

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ، وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ، وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

All-Ilāhumme šal-li ‘alā Muḥam-medin we ‘alā āli Muḥammedin kemā šal-lejte ‘alā Ibrāhīme we ‘alā āli Ibrāhīme, inneke ḥamīdun Mexhīd. All-Ilāhumme bārik ‘alā Muḥammedin we ‘alā āli Muḥammedin, kemā bārakte ‘alā Ibrāhīme we ‘alā āli Ibrāhīme, inneke ḥamīdun Mexhīd.

(O Allah lavdëroje (te melekët e lartë) Muhamedin dhe familjen e tij⁷⁹, ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar. O Allah begatoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar).⁸⁰

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ. وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ. إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

All-Ilāhumme šal-li ‘alā Muḥammedin we ‘alā ezwāxhihi we dhurrijjetihi, kemā šal-lejte ‘alā āli Ibrāhīme, we bārik ‘alā Muḥammedin we ‘alā ezwāxhihi we dhurrijjetihi kemā bārakte ‘alā āli Ibrāhīme, inneke ḥamīdun Mexhīd.

⁷⁹[Ibn Kajim sqaron se, sipas mendimit më të saktë, te familja (alu) hyjnë gratë e Pejgamberit ﷺ, pasardhësit e tij, si dhe të afërmit e tij, të cilëve nuk u jepet sadaka].

⁸⁰Buhariu.

(O Allah lavdëroje (te melekët e lartë) Muhamedin, bashkëshortet dhe pasardhësit e tij, ashtu siç lavdërove familjen e Ibrahimit, (O Allah) begatoje Muhamedin, bashkëshortet dhe pasardhësit e tij, ashtu siç begatove familjen e Ibrahimit, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar).⁸¹

24-LUTJA NË ULJEN E FUNDIT PARA SELAMIT

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا
وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ.

All-Ilāhumme innĩ e’ūdhu bike min ‘adhābil kabri, we min ‘adhābi xhehennem, we min fitnetil maḥjā wel memāt! We min sherri fitnetil mesīhid-dexh-xhāl.

(O Allah! Më ruaj nga dënimi i varrit! Më ruaj nga dënimi i Xhehenemit! Më ruaj nga sprovat gjatë jetës e pas vdekjes! Më ruaj nga sherri i provës së Mesihut Dexhal!).⁸²

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ، وَأَعُوذُ
بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ. اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْثَمِ وَالْمَغْرَمِ.

All-Ilāhumme innĩ e’ūdhu bike min ‘adhābil kabri, we e’ūdhu bike min fitnetil mesīhid-dexh-xhāl, we e’ūdhu bike min fitnetil maḥjā wel memāt! All-Ilāhumme innĩ e’ūdhu bike minel me’themi wel meḡrami!

⁸¹Buhariu dhe Muslimi.

⁸²Buhariu dhe Muslimi.

(O Allah! Më ruaj nga dënimi i varrit! Më ruaj nga sprova e Mesihut Dexhal! Më ruaj nga sprovat gjatë jetës e pas vdekjes! O Allah! Më mbroj nga gjynahet dhe nga zhytja në borxhe!).⁸³

اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا، وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ، فَاعْفُزْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي، إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ.

All-Ilāhumme innĩ d̥halemtu nefsĩ d̥hulmen kethĩran, we lã jegfirudh-dhunũbe il-lã Ente, feğfir lĩ mağfıraten min ‘indike, werħamnĩ inneke Entel Ğafūrurr-Rrahĩm.

(O Allah! Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes. Askush veç Teje nuk i fal gjynahet, ndaj më fal mua me mirësinë Tënde dhe më mëshiro, se Ti je Falës dhe Mëshirues!).⁸⁴

Bārakall-Ilāhu leke we bārake ‘alejke we xheme’a bejnekuṃā fī ḥajr!

(Allahu të begatofte me këtë grua, të dhëntë bollëk për ta mbajtur e ushqyer, dhe ju bashkofte të dy në të mirë!).²⁴⁵

²⁴³Buhariu.

²⁴⁴Tirmidhiu (Sahih Ebu Davud).

²⁴⁵Ebu Davudi (Sahih Tirmidhi).

80-LUTJA QË BËN I PORSAMARTUARI PËR VETVETEN, DHE LUTJA QË BËHET NË RASTIN E BLERJES SË KAFSHËS

Pejgamberi ﷺ ka këshilluar që kur dikush martohet, të bëjë këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَهَا، وَخَيْرَ مَا جَبَلْتَهَا عَلَيْهِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا، وَشَرِّ مَا جَبَلْتَهَا عَلَيْهِ.

All-Ilāhumme innī es’eluke ħajrahā, we ħajra mā xhebelteħā ‘alejhi, we e’ūdhu bike min sherrihā we sherri mā xhebelteħā ‘alejhi.

(O Allah! Të lutem ta bësh të mirë e të dobishme për mua dhe të më japësh të mirat që vijnë prej karakterit që Ti i ke dhënë! Të lutem të më mbrosh nga të këqijat që ka kjo (grua) dhe nga të këqijat që vijnë prej karakterit që Ti i ke dhënë!). Po ashtu kur dikush blen një deve, le t’ia kapë me dorë majën e gungës dhe të thotë të njëjtën lutje).²⁴⁶

81-LUTJA PËRPARA SE TË KRYHEN MARRËDHËNIE INTIME

بِسْمِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ جَنِّبْنَا الشَّيْطَانَ، وَجَنِّبِ الشَّيْطَانَ مَا رَزَقْتَنَا.

Bismil-lāh! All-Ilāhumme xhennibnā esh-shejtāne, we xhennibish- shejtāne mā razeķtena.

(Me emrin e Allahut, o Allah! Largoje shejtanin nga ne dhe largoje edhe nga fëmija që Ti na e bën rrizk!).²⁴⁷

²⁴⁶Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe (Sahih Ibn Maxhe).

²⁴⁷Buhariu dhe Muslimi.

82-KUR NEVRIKOSEMI

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

E'ūdhu bil-lāhi minesh-shejtānirr-rraxhīm.

(I lutem Allahut të më ruaj nga shejtani i mallkuar).²⁴⁸

83-KUR SHOHIM NJË PERSON TË SPROVUAR ME SËMUNDJE, TË METË FIZIKE A MENDORE, GJYMTIM OSE GJYNAH

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَافَانِي مِمَّا ابْتَلَاكَ بِهِ، وَفَضَّلَنِي عَلَى كَثِيرٍ مِمَّنْ خَلَقَ تَفْضِيلًا.

Elḥamdu lil-lāhil-ledhī ‘āfānī mim-meb’telāke bihi, we faḍḍalenī ‘alā kethīrin mim-men ḥaleka tefḍīlā.

(Lavdia i takon Allahut, i Cili më ka ruajtur nga kjo sprovë që të ka dhënë ty dhe më ka bërë në një gjendje më të mirë se shumë krijesa!).²⁴⁹

84-GJATË KUVENDIT

Ibn Umeri رضي الله عنه tregon se, gjatë një kuvendi të vetëm, njerëzit i numëronin Profetit صلى الله عليه وسلم të thoshte njëqind herë para se të çohet:

رَبِّ اغْفِرْ لِي، وَتُبْ عَلَيَّ، إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الْعَفُورُ.

Rabbigfir lī we tub ‘alejje! Inneke Entet-Tewwābul Gafūr!

(Zoti im, më fal dhe më prano pendimin! Ti je Pendimpranues dhe Falës i Madh).²⁵⁰

²⁴⁸Buhariu dhe Muslimi.

²⁴⁹Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

85-LUTJA PËR SHLYERJEN E GJYNAHEVE, KUR MBARON TAKIMI A KUVENDI

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ.

**Subhānekall-Ilāhumme we biḥamdike. Eshhedu en lā ilāhe il-lā
Ente. Estagfiruke we etūbu ilejke.**

(I dëlirë nga të metat je Ti, o Allah! Ty të përket lavdia! Dëshmoj se nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Teje! Ty të kërkoj falje dhe para Teje pendohem!).²⁵¹

86-KUR DIKUSH TË THOTË: “ALLAHU TË FALTË”

Kur dikush të thotë: (غَفَرَ اللَّهُ لَكَ) **Ĝaferall-Ilāhu leke!** (Allahu të faltë!), ia kthen: (وَلَكَ) **we lek** (Edhe ty, gjithashtu!).²⁵²

87-LUTJA PËR DIKË, QË TË BËN NDONJË TË MIRË

جَزَاكَ اللَّهُ خَيْرًا.

Xhezākall-Ilāhu ḥajran.

²⁵⁰Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

²⁵¹Ebu Davudi (Sahih Tirmidhi). Në një transmetim të saktë, Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon: “Sa herë që Profeti ﷺ ulej në një kuvend, lexonte Kuran, apo falte ndonjë namaz, e mbyllte me këto fjalë ...”. Shënon Nesaïu në ‘Amelul jeumi uel lejleleti’ dhe në ‘Sunenul Kubra’. Albani thotë se senedi është i saktë (silsile sahiha 7/1/495).

²⁵²Ahmedi dhe Nesaïu në ‘Amelul jeumi uel-lejleti’ shënojnë se, kur Abdullah ibn Serxhisi i tha Pejgamberit: “**Gaferall-Ilāhu lek**”, Pejgamberi ia ktheu: “**Ue leke**”. Hadithi është i saktë.

Allahu të shpërbleftë me të mira!²⁵³

88-PËR TË NA RUAJTUR ALLAHU PREJ DEXHALIT

Pejgamberi ﷺ thotë: “Kushdo që mëson përmendsh dhjetë ajete nga fillimi i sures Kehf, Allahu ka për ta ruajtur prej Dexhalit”.²⁵⁴ Gjithashtu, t’i lutesh Allahut të të ruaj prej sprovës së Dexhalit pas *teshehudit* të fundit dhe para selamit, në çdo namaz”.²⁵⁵

89-PËR DIKË, QË TË THOTË «INNĪ UḤIBUKE FIL-LAH – TË DUA PËR HIR TË ALLAHUT»

أَحَبُّكَ الَّذِي أَحْبَبْتَنِي لَهُ.

Eḥabbekel-ledhī aḥbebtēnī lehu!

(Të dashtë Ai, për hir të të Cilit më do!).²⁵⁶

90-PËR DIKË, QË DËSHIRON TË TË FALË PASURI

بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي أَهْلِكَ وَمَالِكَ.

Bārakall-Ilāhu leke fī ehlike we mālike!

(Allahu të dhëntë bereqet në familjen dhe pasurinë tënde!).²⁵⁷

²⁵³Tirmidhiu (Sahih Xhami).

²⁵⁴Muslimi. Në një transmetim tjetër thuhet: dhjetë ajete nga fundi i sures Kehf.

²⁵⁵Shiko lutjet e namazit para selamit.

²⁵⁶Ebu Davudi (Sahih sunen Ebi Davud).

91-KUR I KTHEJMË BORXHIN HUADHËNËSIT

بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي أَهْلِكَ وَمَالِكَ، إِنَّمَا جَزَاءُ السَّلَفِ الْحَمْدُ وَالْأَدَاءُ.

Bārakall-llāhu leke fī ehlike we mālīke! Innemā xhezāus-selefi elḥamdu wel edāu!

(Allahu të begatoftë familjen dhe pasurinë! S’ka dyshim se shpërblimi për huanë është falënderimi dhe shlyerja e plotë!).²⁵⁸

92-LUTJA E FRIKËS NGA SHIRKU

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أُشْرِكَ بِكَ وَأَنَا أَعْلَمُ، وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا لَا أَعْلَمُ.

All-llāhumme innī e’ūdhu bike en ushrike bike, we ene a’ëlemu we estagfiruke limā lā a’ëlemu!

(O Allah! Unë kërkoj të më ruash nga shirku që unë e di dhe të kërkoj falje Ty për atë që unë nuk e di!).²⁵⁹

93-LUTJA PËR DIKË, QË TË THOTË: “BĀRAKALL-LLĀHU FĪKE – ALLAHU TË BEGATOFTË”

وَفِيكَ بَارَكَ اللَّهُ.

We fike bārakall-llāhu!

(Edhe ty të begatoftë Allahu!).²⁶⁰

²⁵⁷Buhariu.

²⁵⁸Nesaiu (Sahih Ibn Maxhe).

²⁵⁹Ahmedi (Sahih Tergib dhe Terhib).

²⁶⁰Ibn Sunni.

94-KUR PARANDJEN DIÇKA TË URRYER NGA NJË SHENJË BESËTYTNORE (OGURZEZË)

اللَّهُمَّ لَا طَيْرَ إِلَّا طَيْرُكَ، وَلَا خَيْرَ إِلَّا خَيْرُكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ.

All-Ilāhumme lā ʔajra il-lā ʔajruke, we lā ʔajra il-lā ʔajruke, we lā ilāhe ʔajruke!

(O Allah! Nuk ndodh veçse ajo e keqe e caktuar nga Ti! E mira është vetëm në dorën Tënde dhe vjen vetëm prej Teje! S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje!).²⁶¹

95-LUTJA KUR HIPIM NË MJETIN E UDHËTIMIT

بِسْمِ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، ﴿سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ﴾، الْحَمْدُ لِلَّهِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي؛ فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ.

“Bismil-lāh”²⁶² welḥamdu lil-lāh. “Subḥānel-ledhī seḥ-hara lenā ḥādhā, we mā kunna lehū mukṛinīn, we innā ilā Rabbinā le munḳalibūn”. Elḥamdu lil-lāh, Elḥamdu lil-lāh, Elḥamdu lil-lāh! All-Ilāhu Ekber, All-Ilāhu Ekber, All-Ilāhu

²⁶¹Ahmedi dhe Ibn Sunni. Albani thotë se hadithi është i saktë. Nga ana tjetër, Profeti ﷺ e pëlqente shenjën ogurmire, që ngjall optimizëm, andaj njëherë kur i pëlqeu një fjalë e mirë që e dëgjoi prej një burri, tha: «E morëm optimizmin prej gojës tënde». Shënojnë Ebu Davudi dhe Ahmedi. Albani e vlerëson të saktë në ‘Silsile sahiha’ 2/353.

²⁶²Kur vendosim këmbën për të hipur në mjetin e udhëtimit ose në kafshë, themi: «Bismilāh», dhe mbasi ulemi në mjetin e udhëtimit themi shprehjet e tjera të lutjes të përmendura në vijim. Kështu sqarohet në hadith.

Ekber! Subhānekall-Ilāhumme innī dhalemte nefsī, feġfir lī, fe innehu lā jeġfirudh-dhunūbe il-lā Ente.

(Me emrin e Allahut! Falënderimi i takon Allahut! I Dëlrë nga të metat është Ai që na dha mundësi ta përdorim këtë (kafshë a mjet), se ne nuk do të mund ta kishim atë nën pushtet, dhe ne me siguri pas vdekjes do të kthehemi te Zoti ynë! Falënderimi i takon Allahut! Falënderimi i takon Allahut! Falënderimi i takon Allahut! Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi! Allahu është më i Madhi! I Patëmeta je Ti o Allah! Me të vërtetë, unë i kam bërë padrejtësi vetes duke bërë gjynahe, prandaj m'i fal gjynahet, se askush tjetër veç Teje nuk mund t'i falë ato!).²⁶³

96-LUTJA E UDHËTIMIT

اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، ﴿سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ وَإِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ﴾. اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ فِي سَفَرِنَا هَذَا الْبِرَّ وَالتَّقْوَىٰ، وَمِنَ الْعَمَلِ مَا تَرْضَىٰ، اللَّهُمَّ هَوِّنْ عَلَيْنَا سَفَرَنَا هَذَا وَاطْوِ عَنَّا بُعْدَهُ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الصَّاحِبُ فِي السَّفَرِ، وَالْخَلِيفَةُ فِي الْأَهْلِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ وَعْثَاءِ السَّفَرِ، وَكَآبَةِ الْمَنْظَرِ، وَسُوءِ الْمُنْقَلَبِ فِي الْمَالِ وَالْأَهْلِ.

All-Ilāhu Ekber, All-Ilāhu Ekber, All-Ilāhu Ekber! Subhānel-ledhī seħ-ħara lenā hādhā, we mā kunnā lehū muḵrinīn, we inna ilā Rabbinā le munḵalibūn. All-Ilāhumme innā nes’eluke fī seferinā hādhā el birr-rra wet-taḵwā, we minel ‘ameli mā terḍā, All-Ilāhumme hewwin ‘alejnā seferanā hādhā, weṭwi ‘annā bu’ēdehu, All-Ilāhumme Enteş-şāhibu fis-seferi, wel ḥalīfetu fil

²⁶³Ebu Davudi dhe Tirmidhiu. (Sahih Tirmidhi).

ehli, All-Ilāhumme innī e’ūdhu bike min wa’ēthāis-sefer, we keābetil mendhar, we sūil munḳalebi fil māli wel ehl.

(Allahu është më i Madhi! Allahu është më i Madhi! Allahu është më i Madhi! “I Pastër nga të metat është Ai që na dha mundësi ta përdorim këtë (kafshë a mjet), se ne nuk do të mund ta kishim atë në përdorim, dhe ne me siguri pas vdekjes do të kthehemi te Zoti ynë!”. O Allah! Ne të lutemi që, në këtë udhëtim, të na mundësosh të bëjmë vepra të mira, të ruhemi nga gjynahet dhe të bëjmë ato punë të cilat Ti i pëlqen! O Allah! Na e lehtëso udhëtimin dhe na e mundëso ta përshkojmë shpejt dhe pa vështirësi distancën e largët! O Allah! Ti je Shoqëruesi (Ruajtësi dhe Ndihmuesi) ynë në udhëtim dhe Ai që kujdeset për familjet tona. O Allah, më ruaj nga vështirësitë e udhëtimit, nga pamja e gjendja e trishtueshme dhe nga kthimi hidhërues për gjendjen e pasurisë dhe të familjes!). Edhe kur kthehesh, thuhet të njëjtat fjalë, duke shtuar:

آيُّوْنَ، تَائِبُوْنَ، عَابِدُوْنَ، لِرَبِّنَا حَامِدُوْنَ.

Ājibūne, tāibūne, ‘ābidūne li rabbinnā ḥāmidūn!

(Po kthehemi nga udhëtimi të penduar për gjynahet, adhurues, dhe falënderues ndaj Zotit tonë!).²⁶⁴

²⁶⁴Muslimi.

97-LUTJA KUR HYJMË NË NJË QYTET OSE VENDBANIM

اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَمَا أَظْلَلْنَ، وَرَبَّ الْأَرْضِينَ السَّبْعِ وَمَا أَقْلَلْنَ، وَرَبَّ الشَّيَاطِينِ وَمَا أَضْلَلْنَ، وَرَبَّ الرِّيَاحِ وَمَا ذَرَيْنِ، أَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذِهِ الْقَرْيَةِ، وَخَيْرَ أَهْلِهَا، وَخَيْرَ مَا فِيهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا، وَشَرِّ أَهْلِهَا، وَشَرِّ مَا فِيهَا.

All-Ilāhumme Rabbes-semāwātis-seb'i we mā aḍhlelne we rabbel erāḍīnes-seb'i we mā aḳlelne, we Rabbesh-shejāṭīni we mā aḍlelne, we Rabberr-ri jāḥi we mā dherajne! Es'eluke ḥajra ḥādhihil ḳarjeti we ḥajra ehlihā we ḥajra mā fihā, we e'ūdhu bike min sherrihā we sherri ehlihā we sherri mā fihā.

(O Allah, Zot i shtatë qiejve dhe gjithçkaje që qiejtë kanë nën strehë! Zot i shtatë tokave dhe gjithçkaje që ato mbajnë! Zot i shejtanëve dhe atyre që ata i kanë çuar në humbje! Zot i erës dhe asaj që ato shpërndajnë! Të lutem të më japësh të mirën e këtij vendbanimi, të mirën që vjen nga banorët e tij, të mirën e gjithçkaje që gjendet në të! Të kërkoj të më mbrosh nga dëmi i këtij vendbanimi, dëmi i banorëve të tij dhe dëmi i gjithçkaje në të!).²⁶⁵

²⁶⁵Hakimi dhe Ibn Sunni.

98-LUTJA KUR HYJMË NË TREG

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، يُحْيِي وَيُمِيتُ، وَهُوَ حَيٌّ لَا يَمُوتُ، بِيَدِهِ الْخَيْرُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

Lă ilăhe il-lall-ilăhu waḥdehu lă sherike leh, lehul mulku we lehul ḥamdu, juḥḥī we jumīt, we huwe Ḥajjun lă jemūtu, bi jedihil ḥajru, we huwe ‘ală kul-li shej’in ḳaḏīr.

(S’ka të adhurar me të drejtë veç Allahut, Një dhe i Pashoq! Atij i takon sundimi dhe lavdia. Ai jep jetë dhe jep vdekje! Ai është i Gjallë, i Pavdekshëm! E gjithë e mira është në dorë të Tij. Dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë!).²⁶⁶

99-KUR KAFSHA E UDHËTIMIT PENGOHET

بِسْمِ اللَّهِ

Bismil-lăh.

(Me emrin e Allahut).²⁶⁷

100-LUTJA E UDHËTARIT PËR NJERËZIT, KUR NDAHET ME TA PËR UDHËTIM

أَسْتَوْدِعُكُمُ اللَّهَ، الَّذِي لَا تَضِيعُ وَدَائِعُهُ.

Estewdi’ukumull-ilăhe el-ledhī lă teḏī’u wedăi’uhu.

(Ju lë amanet tek Allahu, të Cilët nuk i humbin amanetet).²⁶⁸

²⁶⁶Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

²⁶⁷Ebu Davud (Sahih Ebu Davud).

101-LUTJA PËR UDHËTARIN KUR NISËT PËR UDHËTIM

أَسْتَوْدِعُ اللَّهَ دِينَكَ، وَأَمَانَتَكَ، وَخَوَاتِيمَ عَمَلِكَ.

Estewdi’ull-Ilāhe dīneke we emānetek, we ḥawātīme ‘amelike!

(Po i lë amanet Allahut fenë tënde, amanetin²⁶⁹ tënd dhe përfundimin e veprave të tua!).²⁷⁰

زَوَّدَكَ اللَّهُ التَّقْوَى، وَغَفَرَ ذُنُوبَكَ، وَيَسَّرَ لَكَ الْخَيْرَ حَيْثُ مَا كُنْتَ.

Zewwedekall-Ilāhut-taḳwā, we ḡafera dhenbeke, we jessera lekel ḥajra ḥajthu mā kunte!

(Allahu të pajistë me devotshmëri! Allahu të faltë gjynahun! Allahu ta bëftë mbarë të mirën, kudo qofsh!).²⁷¹

102-THËNIA ALLĀHU EKBER DHE SUBḤĀN-ALLĀH GJATË ECJES NË UDHËTIM

Xhabiri ﷺ tregon se kur ngjiteshin përpjetë, thonin (اللَّهُ أَكْبَرُ) **All-Ilāhu Ekber**, kurse kur zbrisnin tatëpjetë, thonin (سُبْحَانَ اللَّهِ) **‘Subḥānall-Ilāh’**.²⁷²

²⁶⁸Ahmedi (Sahih Ibn Maxhe).

²⁶⁹[Domethënë: familjen, pasurinë, amanetet që u ke lënë njerëzve dhe amanetet që të kanë lënë ata].

²⁷⁰Ahmedi (Sahih Tirmidhi).

²⁷¹Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

²⁷²Buhariu.

103-LUTJA QË BËN UDHËTARI NGA FUNDI I NATËS, PAK PARA AGIMIT

سَمِعَ سَامِعٌ بِحَمْدِ اللَّهِ، وَحُسْنِ بَلَائِهِ عَلَيْنَا، رَبَّنَا صَاحِبِنَا، وَأَفْضَلِ عَلَيْنَا عَائِدًا بِاللَّهِ
مِنَ النَّارِ.

Semme'a sāmi'un²⁷³ bihamdil-lāhi we ḥusni belāihi 'alejnā, Rabbenā ṣāhibnā we efdil 'alejnā 'āidhen bil-lāhi minen-nār.

(Kush dëgjon lavdin që po i bëjmë Allahut për begatitë dhe mirënjohjen që po i shprehim Atij për mirësitë, le t'ia përcjellë një tjetri!²⁷⁴ O Zoti ynë! Na ruaj dhe na jep mirësi! I lutemi Allahut të na mbrojë nga Zjarri!).²⁷⁵

104-LUTJA KUR QËNDROJMË DIKU NË NJË VEND, QOFSHIM UDHËTARË APO JO

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ.

E'ūdhu bi kelimātil-lāhit-tāmmāti min sherri mā ḥaleq.

(Mbrohem me fjalët e përkryera të Allahut nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar!).²⁷⁶

²⁷³[Ose: "Semi'a sāmi'un"].

²⁷⁴[Dmth., kush e dëgjon këtë dhikër prej meje, le ta bëjë atë vetë dhe le t'ia thotë edhe një tjetri, në mënyrë që në këtë kohë secili t'i bëjë hamd (lavdi) Allahut, t'i bëjë dhikër Atij dhe t'i lutet. Sipas variantit tjetër kuptimi është kështu: «Kushdo që dëgjon, le të dëshmojë për *hamdin* që po i bëjmë Allahut dhe mirënjohjen që po i shprehim Atij për mirësitë»].

²⁷⁵Muslimi.

²⁷⁶Muslimi.

105-DHIKRI GJATË KTHIMIT NGA UDHËTIMI

Kur kthehej nga udhëtimi i luftës ose haxhit, Profeti ﷺ bënte tri *tekber*-e mbi çdo vend të ngritur të tokës, e pastaj thoshte:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،
آيُّونَ، تَائِبُونَ، عَابِدُونَ، لِرَبِّنَا حَامِدُونَ، صَدَقَ اللَّهُ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ عَبْدَهُ، وَهَزَمَ
الْأَخْزَابَ وَحْدَهُ.

Lă ilăhe il-lall-Ilăhu waḥdehu lă sherîke leh, lehul mulku, we lehul ḥamdu, we huwe ‘ală kul-li shej’in ḳaḏîr, âjibûne, tâibûne, ‘âbidûne, li Rabbină ḥămidûn.

Sadeḳall-Ilăhu wa’ēdehu, we neṣara ‘abdehu, we hezemel aḥzābe waḥdehu.

(S’ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, Një dhe i Pashoq! Vetëm Atij i përket sundimi dhe lavdia. Ai është i Fuqishëm për çdo gjë! Po kthehemi nga udhëtimi të penduar për gjynahet, adhures dhe falënderues ndaj Zotit tonë!

Allahu e përmbushi premtimin e Vet (me ngadhënjimin e fesë), e ndihmoi robin e Vet për fitoren kundër qafirëve dhe i mposhti i Vetëm grupet aleate (në luftën e Hendekut, pa bërë luftë muslimanët)).²⁷⁷

²⁷⁷Profeti ﷺ e bënte këtë dhikër kur kthehej nga ndonjë betejë ose nga haxhi. Buhariu dhe Muslimi.

106-KUR NA VJEN DIÇKA QË NA GËZON OSE DIÇKA QË NUK NA PËLQEN

Kur i vinte diçka që e gëzonte, Profeti ﷺ thoshte:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي بِنِعْمَتِهِ تَتِمُّ الصَّالِحَاتُ.

Elḥamdu lil-lāhili-ledhī bi ni’emetihi tetimmuş-şāliḥāt.

(Lavdia i takon Allahut, me mirësinë e të Cilit plotësohen të mirat).

E kur i vinte diçka e padëshiruar, thoshte:

الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى كُلِّ حَالٍ.

Elḥamdu lil-lāhi ‘alā kul-li ḥāl.

(Lavdia i takon Allahut për çfarëdolloj gjendjeje!).²⁷⁸

107-MIRËSIA QË KEMI, KUR BËJMË ‘SALAVAT’ PËR PEJGAMBERIN ﷺ

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“Kush bën një herë *salavat* për mua, Allahu i Lartësuar ka për ta lavdëruar dhjetë herë (te melekët)”.²⁷⁹

“Mos e bëni varrin tim vend feste, ku vini apo grumbulloheni në kohë sezonale të caktuara, por dërgoni *salavat*-e për mua, sepse *salavatet* tuaja më arrijnë kudo që të jeni”.²⁸⁰

²⁷⁸Ibn Sunni në «‘Amelul jeumi uel lejleti» dhe Hakimi (Sahih Xhami).

²⁷⁹Muslimi.

²⁸⁰Ebu Davudi dhe Ahmedi (Sahih Ebu Davud).

“Koprrac i madh është ai që, kur unë përmendem në prani të tij, nuk bën *salavat* për mua”²⁸¹.

“Allahu ka melekë që shëtisin në Tokë dhe më përcjellin selamin e umetit tim”.²⁸²

“Nuk ka njeri që lutet për selam për mua, e që Allahu të mos ma kthejë shpirtin për t’i kthyer selamin”.²⁸³

108-PËRSHËNDETJA ME SELAM

Pejgamberi ﷺ thotë: “Nuk do të hyni në Xhenet pa u bërë besimtarë, dhe nuk mund të bëheni besimtarë të mirë (me iman të plotë) derisa ta doni njëri-tjetrin. A t’ju tregoj diçka që, nëse do ta kryeni, do të duheni mes vete; përhapni përshëndetjen me selam ndërmjet jush”.²⁸⁴

Amari ﷺ thotë: “Nëse ke tri veti, e përsos imanin: Të gjykosh drejt dhe t’u japësh hakun të tjerëve në gjërat që prekin interesat vetjake, t’u japësh selam të gjithë njerëzve (atyre që i njeh dhe atyre që s’i njeh) dhe të bësh mirë me pasuri edhe kur nuk ke.”²⁸⁵

Abdullah ibn Umeri ﷺ tregon se një burrë pyeti Pejgamberin ﷺ se cilat janë punët më të mira të Islamit: “Pejgamberi ﷺ u

²⁸¹Tirmidhiu (Sahih Xhami).

²⁸²Nesaiu (Sahih Nesai). [Për të çuar salavat dhe selam për Pejgamberin, kur përmendim a dëgjojmë emrin e tij, themi: “**Ṣal-lill-Ilāhu ‘alejhi we ‘alā ālihi we sel-lem**”, ose: “**‘Alejhiṣ-ṣalātu wes-selām**”. Selami për Pejgamberin është lutja që Allahu t’i japë atij paqe dhe ta ruajë nga të këqijat].

²⁸³Ebu Davud (Sahih Ebu Davud).

²⁸⁴Muslimi.

²⁸⁵Buhariu, por si thënie të Amarit ﷺ.

përgjigj: të japësh ushqim (nevojtarëve, mysafirëve etj.) dhe t'i japësh salam atij që e njuh dhe atij që s'e njuh.”²⁸⁶

109-KUR NJË JOMUSLIMAN NA JEP SELAM

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Nëse ju japin salam ithtarët e Librit, kthejuani:

وَعَلَيْكُمْ.

“We ‘alejkum!”.

(Edhe mbi ju).²⁸⁷

110-KUR DËGJON KËNDIMIN E GJELIT DHE PËLLITJEN E GOMARIT

Pejgamberi ﷺ thotë:

“Kur të dëgjoni gjelin duke kënduar, luteni Allahun që t’ju japë nga mirësitë e Tij (të thuash):

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ.

All-Ilāhumme innī es’eluke min faḍlik!, sepse gjeli ka parë një melek.

Ndërsa kur të dëgjoni gomarin duke pëllitur, kërkoni mbrojtje tek Allahu nga shejtani (të thuash):

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

²⁸⁶Buhariu dhe Muslimi.

²⁸⁷Buhariu dhe Muslimi.

E'ūdhu bil-lāhi minesh-shejtānirr-rraxhīm, sepse gomari ka parë një shejtan.”²⁸⁸

111-LUTJA KUR DËGJOJMË QENTË DUKE LEHUR NATËN

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم thotë:

“Kur të dëgjoni natën qentë duke lehur dhe gomerët duke pëllitur, lutjuni Allahut t’ju ruajë prej shejtanit, sepse ata shohin atë që ju nuk e shihni”.²⁸⁹

112-LUTJA QË BËN PËR DIKË, QË MUND TA KESH OFENDUAR

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم ka thënë:

اللَّهُمَّ فَإِنَّمَا مُؤْمِنٌ سَبَّيْتُهُ؛ فَاجْعَلْ ذَلِكَ لَهُ قُرْبَةً إِلَيْكَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ.

All-llāhumme fe ejjumā mu'minin sebeb-tuhu fexh'al dhālike lehu քurbeten ilejke jewmel քijāmeħ.

“O Allah, cilindo besimtar që e kam ofenduar, bëje këtë gjë afrim për të tek Ti Ditën e Gjykimit”.²⁹⁰

²⁸⁸Buhariu dhe Muslimi.

²⁸⁹Ebu Davudi dhe Ahmedi (Sahih Ebu Davud).

²⁹⁰Buhariu dhe Muslimi, por ky i fundit e sjell kështu: «... bëje këtë gjë pastrim gjynahesh dhe mëshirë për të».

113-FJALËT QË DUHET TË THUASH KUR LAVDËRON NJË MUSLIMAN

Pejgamberi ﷺ thotë:

“Nëse ndonjëri patjetër do ta lavdërojë shokun, atëherë le të thotë: Mendoj se filani është kështu e ashtu (p.sh., njeri i mirë), kur e njeh për të tillë, porse *Allahu do ta gjykojë punën e tij, ndërsa unë nuk gjykoj prerë përpara Allahut për askënd se ka zemër të pastër dhe se do të ketë përfundim të mirë.*”

وَاللَّهُ حَسِيبُهُ وَلَا أَرْكِي عَلَى اللَّهِ أَحَدًا.

(Wall-Ilāhu ḥasībuhu we lā uezekkī ‘alall-Ilāhi eḥadā).²⁹¹

114-LUTJA QË BËN MUSLIMANI KUR DIKUSH E LAVDËRON

اللَّهُمَّ لَا تُؤَاخِذْنِي بِمَا يَقُولُونَ، وَاعْفُ عَنِّي مَا لَا يَعْلَمُونَ، [وَاجْعَلْنِي خَيْرًا مِمَّا يَطْنُونَ].

All-Ilāhumme lā tuāḥidhnī bimā jeḵūlūn, weḡfir lī mā lā ja’ēlemūn, wexh’alnī ḥajran mim mā jeḏhunūn!

(O Allah, mos më dëno për lavdërimet që më bëjnë. M’i fal gjynahet që ata nuk i dinë! Më bëj më të mirë sesa mendojnë ata!).²⁹²

²⁹¹Muslimi. [Kur lavdërojmë dikë, duhet të themi dhikrin në arabisht të shënuar më lart ndërmjet kllapave, ose kuptimin e tij në shqip të shënuar më lart me shkrim të pjerrët].

²⁹²Buhariu shënon në Edebul Mufred se shokët e Pejgamberit ﷺ në një rast të tillë thonin lutjen e mësipërme. Porse fjalia e fundit është një shtojcë që e sjell Bejhakiu, nga një rrugë tjetër, si lutje që e bënin disa nga të parët e umetit.

**115-SI BËJMË TELBIJE KUR JEMI NË GJENDJE IHRAMI PËR
HAXH OSE UMRE**

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ، وَالنِّعْمَةَ، لَكَ وَالْمُلْكَ، لَا
شَرِيكَ لَكَ.

**Lebbejkall-Ilāhumme lebbejk, leb-bejke lã sherîke leke lebbejk!
Innel hamde, wen-ni'ëmete, leke wel mulk. Lã sherîke lek!**

(O Allah, unë i përgjigjem thirrjes Tënde, i dorëzohem vendimit Tënd dhe respektoj urdhrin Tënd. [E thotë herë pas here]. Kështu kam për të vazhduar gjithmonë. Ti nuk ke shok. Vërtet, lavdia dhe pushteti të përkasin vetëm Ty. Mirësitë i jep vetëm Ti).²⁹³

**116-KUR FILLON TAVAFIN TE KËNDI I GURIT TË ZI DHE SA
HERË QË FILLON XHIROT E TAVAFIT ATY BËN TEKBIRE**

Pejgamberi ﷺ e bëri tavafin rreth Qabesë hipur mbi deve. Sa herë që vinte te Guri i Zi bënte shenjë drejt tij me kërrabën që kishte në dorë dhe bënte *tekbir* (Allāhu ekber).²⁹⁴

²⁹³Buhariu dhe Muslimi. [Telbija është formula e dhikrit të mësipërm që thuhet me zë në gjendje ihrami. Ajo tregon përgjigje ndaj thirrjes së Allahut të Lartësuar për të bërë haxh te Qabeja].

²⁹⁴Buhariu.

117-LUTJA KUR KALON MES KËNDIT TË JEMENIT DHE GURIT TË ZI

﴿رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ﴾

**Rabbenã, âtinã fid-dunjã ḥaseneten, we fil âhirati ḥaseneten,
we ḳinã ‘adhâben-nâr!**

(Zoti ynë, na jep të mira në këtë jetë, dhe në jetën e fundit na jep
të mira, dhe na ruaj prej dënimit në Zjarr!).²⁹⁵

118-LUTJA KUR QËNDRON MBI SAFA DHE MBI MERVE

Kur Profeti ﷺ u afrua te Safaja lexoi fjalën e Allahut të
Lartësuar:

إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ.

Inneş-şafã wel merwete min she’âiril-lâh.

(Safa dhe Merveja janë, pa dyshim, nga shenjat e qarta të fesë së
Allahut...).

أَبْدَأُ بِمَا بَدَأَ اللَّهُ بِهِ.

Eb’deu bimã bede’All-ilâhu bihi.

(Po e filloj me atë që e ka filluar edhe Allahu).²⁹⁶ Kësisoj ai filloi
me Safanë, u ngjit mbi kodrinë, nga ku dukej Qabeja, u kthye drejt
saj, njësonte Allahun, dhe thoshte:

²⁹⁵Ebu Davudi dhe Ahmedi (Sahih Ebu Davud). Ajeti është në suren Bekare, 201.

²⁹⁶[Këtë ajet dhe këtë pjesë dhikri Pejgamberi ﷺ e tha veçse kur filloi xhiron e parë te Safaja, dhe jo në xhirot e tjera dhe as te Merveja].

اللَّهُ أَكْبَرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ، أَنْجَزَ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ عَبْدَهُ، وَهَزَمَ الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ.

All-Ilāhu ekber. Lā ilāhe il-lall-Ilāhu waḥdehu lā sherīke leh. Lehul mulku we lehul ḥamdu we huwe ‘alā kul-li shej’in ḡadīr. Lā ilāhe il-lall-Ilāhu waḥdehu, enxheze wa’ēdehu, we neṣara ‘abdehu, we hezemel aḡzābe waḥdehu!

(Allahu është më i madhi. Nuk ka të adhurar tjetër të merituar veç Allahut, Ai është i Vetëm dhe i Pashoq. Atij i takon sundimi dhe lavdia, dhe Ai është i Plotpushtetshëm për gjithçka. Nuk ka të adhurar tjetër të merituar veç Allahut. Ai e përmbushi premtimin e Tij, i dhuroi fitoren robit të Tij dhe i mposhti ushtritë të Vetëm). Ai përsëriti këtë *dhikër* tri herë dhe ndërmjet këtyre herëve bënte lutje.

Profeti ﷺ veproi edhe mbi Merva, ashtu siç veproi mbi Safa.²⁹⁷

119-LUTJA E DITËS SË ARAFATIT

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Lutja më e mirë është lutja e ditës së Arafatit, dhe *dhikr*-i më i mirë që kam bërë unë dhe lajmëtarët (enbijatë) para meje është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

Lā ilāhe il-lall-Ilāhu waḥdehu lā sherīke leh, lehul mulku we lehul ḥamdu we huwe ‘alā kul-li shej’in ḡadīr.

²⁹⁷Muslimi.

(Nuk ka të adhuruar me meritë veç Allahut, të Vetëm dhe të Pashoq! I Tij është pushteti dhe Atij i takon lavdia! Dhe Ai për gjithçka është i Plotpushtetshëm!).²⁹⁸

120-DHIKRI QË BËHET NË MESH'AR EL HARAM

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم i hipi devesë së tij të quajtur *Kasua* dhe vazhdoi të ecte, derisa mbërriti në Mesh'ar el Haram (një kodër në Muzdelife). Kur mbërriti atje, u drejtua nga kibla dhe filloi të bënte lutje, tekbire, të thoshte '**Lā ilāhe il-lall-ilāh**' dhe të bënte dhikrin e teuhidit.

(Lā ilāhe il-lall-ilāhu waḥdehu lā sherīke leh, lehul mulku we lehul ḥamdu we huwe 'alā kul-li shej'in ḳaḍīr).

Ai vazhdoi në këtë gjendje, derisa u përhap plotësisht drita e agimit, por ende pa lindur dielli, u largua për në Mina.²⁹⁹

121-KUR HEDHIM GURËT TE XHEMERATET, ÇDO GUR E SHOQËROJMË ME TEKBIR

Të bësh *tekbir* kur hedh secilin gur, tek të tre *xhemeratet*. Mbasi hedh gurët te secili prej *xhemeratit* të parë dhe të dytë, të ecësh pak përpara, të qëndrosh në këmbë dhe të bësh lutje me duar të ngritura i drejtuar nga Kibleja. Ndërsa te *xhemerati* i *Akabesë* (i madhi) nuk qëndron për të bërë lutje pas hedhjes së gurëve, por largohesh.³⁰⁰

²⁹⁸Tirmidhiu (Sahih Tirmidhi).

²⁹⁹Muslimi.

³⁰⁰Buhariu (1664) dhe Muslimi.

122-KUR SHPREHIM HABI DHE KUR DIÇKA NA GËZON

سُبْحَانَ اللَّهِ.

Subhānall-Ilāh!

(I Dëlrë nga të metat është Allahu!).³⁰¹

اللَّهُ أَكْبَرُ.

All-Ilāhu ekber.

(Allahu është më i Madhi!).³⁰²

123-KUR NA VJEN NJË LAJM I GËZUESHËM

Pejgamberi ﷺ, kur i vinte diçka që e gëzonte, binte në sexhde për Allahun e Lartmadhërishëm, si falënderim për Të.³⁰³

124-KUR NDIEN DHIMBJE NË TRUP

Pejgamberi ﷺ thotë:

“Vendose dorën tënde në vendin që të dhemb në trup dhe thuaj:

بِسْمِ اللَّهِ.

‘Bismil-lāh’ (tri herë).

Pastaj thuaj shtatë herë:

³⁰¹Buhariu (3284), (5864) dhe Muslimi (2388).

³⁰²Buhariu (89), (364), (5864), Tirmidhiu (2180) dhe Ahmed (21950).

³⁰³Katër sunenet përveç Nesaiut (Sahih Ibn Maxhe dhe Irvaul Galil).

أَعُوذُ بِاللَّهِ وَقُدْرَتِهِ مِنْ شَرِّ مَا أَجِدُ وَأُحَازِرُ.

E’ūdhu bil-lāhi, we ʔudratihi min sherri mā exhidu, we uḥādhiru!

(Kërkoj mbrojtje tek Allahu dhe me pushtetin e tij nga e keqja që po vuaj dhe nga e cila po bëhem merak!).³⁰⁴

125-KUR NDOJËRI KA FRIKË SE MERR DIÇKA MËSYSH

Pejgamberi ﷺ thotë:

“Kur ndonjëri prej jush sheh te vëllai i tij, ose vetvetja, ose pasuria e tij, diçka që i pëlqen, le të bëjë lutje për bereqet (اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَيْهِ) – **“All-ilāhumme barik ‘alejhi!”** (O Allah, begatoje atë dhe shtoja të mirat!) – pasi mësyshi është hak.³⁰⁵

126-KUR TREMBEMI NGA DIÇKA

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ.

Lā ilāhe il-lall-ilāh.

(S’ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut).³⁰⁶

³⁰⁴Muslimi.

³⁰⁵Ahmedi, Ibn Maxhe dhe Maliku (Sahih Ibn Maxhe).

³⁰⁶Buhariu dhe Muslimi.

127-KUR THERIM NJË BAGËTI

بِسْمِ اللَّهِ وَاللَّهُ أَكْبَرُ [اللَّهُمَّ مِنْكَ وَلَكَ] اللَّهُمَّ تَقَبَّلْ مِنِّي.

Bismil-lāhi wall-Ilāhu ekber, All-Ilāhumme minke we leke, All-Ilāhumme teqabbel minnī.

(Në emër të Allahut. Allahu është më i madhi. O Allah, ky kurban është mirësi prej Teje dhe po theret vetëm për Ty! O Allah, pranoje atë prej meje).³⁰⁷

128-LUTJA QË THUHET PËR LARGIMIN E KURTHIT TË SHEJTANËVE MË TË KËQIJ

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ الَّتِي لَا يَجَاوِزُهُنَّ بَرٌّ وَلَا فَاجِرٌ: مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ، وَبَرًّا وَذَرًّا، وَمِنْ شَرِّ مَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ، وَمِنْ شَرِّ مَا يَخْرُجُ فِيهَا، وَمِنْ شَرِّ مَا ذَرَأَ فِي الْأَرْضِ، وَمِنْ شَرِّ مَا يَخْرُجُ مِنْهَا، وَمِنْ شَرِّ فِتَنِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ، وَمِنْ شَرِّ كُلِّ طَارِقٍ إِلَّا طَارِقًا يَطْرُقُ بِخَيْرٍ يَا رَحْمَنُ.

E'ūdhu bi kelimātil-lāhit-tāmmātil-letī lā juxhāwizuhunne berrun, we lā fāxhirun min sherri mā ḥaleka, we berae, we dherae, we min sherri mā jenzilu mines-semāi, we min sherri mā ja'ëruxhu fihā, we min sherri mā dherae fil erḍi, we min sherri mā jehruxhu minhā, we min sherri fitenil-lejli wen-nehāri, we min sherri kul-li ṭāriqin, il-lā ṭārikan jeṭruku bi ḥajrin, jā Rahmān.

(Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut, të cilat nuk i kalojnë dot³⁰⁸ as të mirët as të këqijtë, nga sherri i gjithçkaje që Ai

³⁰⁷Muslimi dhe Bejhakui.

ka krijuar, nga sherri i gjithçkaje që zbret nga qielli (dënimeve), nga sherri i gjithçkaje që ngjitet në të (punëve të këqija që sjellin dënim), nga sherri i çdo krijese mbi sipërfaqen e tokës, nga sherri i çdo gjëje që del prej nëntoke, nga sherri i sprovave të natës dhe të ditës, nga sherri i çdo ndodhie, përveç një ndodhie që vjen me të mirë, o Mëshirues!).³⁰⁹

129-KËRKIMI I FALJES (ISTIGFARI) DHE PENDIMI (TEUBEJA)

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Për Allahun, unë i kërkoj falje Allahut dhe kthehem tek Ai me pendim më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë.”³¹⁰

“O njerëz, bëni teube tek Allahu, sepse unë bëj teube tek Ai njëqind herë në ditë.”³¹¹

Kush thotë:

أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الْعَظِيمَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ.

Estağfirrull-İlâhel ‘ađñĩm el-ledhĩ lâ ilâhe il-lâ huwel Ĥajjũl Ĥajjũmu we etũbu ilejhi.

(I kërkoj falje Allahut Madhështor, përveç të Cilit nuk ka të adhuruar të vërtetë dhe i Cili është i Gjallë, i Përjetshëm, Mbajtësi i

³⁰⁸[Kjo do të thotë që nuk i kalojnë dot në përsosuri, ose do të thotë që fjalët e përsosura të Kuranit, me lajmet e vërteta (tregimet, premtimet për shpërblim dhe paralajmërimet për dënim) dhe dispozitat e drejta, përfshijnë çdokënd, qoftë i mirë a i keq].

³⁰⁹Ahmedi dhe Ibn Sunni.

³¹⁰Buhariu. [Formula e istigfarit dhe teubes:

“Estağfirrullâhe we etũbu ilejhi”].

³¹¹Muslimi dhe Ebu Davudi.

gjithçkaje, dhe kthehem me pendim tek Ai, pra atë që thotë kështu, Allahu e fal qoftë edhe nëse ka ikur nga beteja).³¹²

“Koha kur Zoti është më afër robit është një e treta e fundit e natës,³¹³ prandaj përpiku që në këtë orë të jesh prej atyre që i bëjnë dhikër Allahut.”³¹⁴

“Robi është më afër me Zotin e tij, kur është në sexhde, prandaj bëni sa më shumë lutje (kur jeni në këtë gjendje)”.³¹⁵

“Ndonjëherë zemra ime mund ta humbë vëmendjen nga dhikri i Allahut, e për këtë arsye unë i kërkoj falje Allahut, çdo ditë, njëqind herë.”³¹⁶

130-MIRËSIA QË KEMI KUR THEMI:

Subhānall-Ilāh, El hamdu lil-lāh, Lā ilāhe il-lall-Ilāh dhe All-Ilāhu Ekber.

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“Kush thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ.

“Subhānall-Ilāhi we biḥamdihi!” do t’i fshihen gjynahet, qofshin edhe sa shkuma e detit.”³¹⁷

³¹²Ebu Davud, Tirmidhiu dhe Hakimi (Sahih Tirmidhi).

³¹³[Kjo kohë fillon kur hyn një e treta e fundit e natës. Më saktësisht, nëse do ta ndanim natën në gjashtë pjesë, i bie që kjo kohë të jetë pjesa e pestë e natës].

³¹⁴Tirmidhiu, Nesaiu dhe Hakimi (Sahih Tirmidhi).

³¹⁵Muslimi.

³¹⁶Muslimi.

Kush thotë dhjetë herë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

Lă ilāhe ilall-Ilāhu waḥdehu lă sherîke leh, lehul mulku we lehul ḥamdu we huwe ‘alā kul-li shej’in ḳaḏîr.

(S’ka të adhurar me të drejtë veç Allahut, Një dhe i Pashoq! Atij i takon sundimi dhe lavdia, dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë!”, ka shpërblim si ai që liron nga skllavëria katër vetë prej pasardhësve të Ismailit).³¹⁸

“Dy fjalë janë të lehta për t’u shqiptuar me gjuhë, të rënda në peshore dhe të dashura te Mëshiruesi:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ، سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ.

Subḥānall-Ilāhi we biḥamdihi, Subḥānall-Ilāhil ‘aḏhīm.

((Shpreh lartësimin se) Allahu është i Dëlrë nga të metat, duke e ngritur lart dhe lavdinë e Tij! Allahu i Madhëruar është i Dëlrë nga çdo e metë!).³¹⁹

«Të them: **“Subḥānall-Ilāh, wel-ḥamdu lil-lāh, we lă ilāhe il-lall-Ilāh, wall-Ilāhu ekber”**, e dëshiroj më shumë, sesa të kisha gjithçka që kapin rrezet e diellit.”³²⁰

Pejgamberi ﷺ tha njëherë: “A nuk keni mundësi të fitoni çdo ditë një mijë të mira?!” Njëri nga ata që ishin ulur me të pyeti: “Si mund të fitosh një mijë të mira?” Pejgamberi ﷺ iu përgjigj:

³¹⁷Buhariu dhe Muslimi.

³¹⁸Buhariu dhe Muslimi.

³¹⁹Buhariu dhe Muslimi.

³²⁰Muslimi.

“Duke thënë njëqind herë: ‘*Subhānall-Ilāh*’, se kështu të shkruhen një mijë të mira, ose të fshihen një mijë gjynahe.”³²¹

“Kush thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ وَيَحْمَدِهِ.

Subhānall-Ilāhil ‘adhīm we bihamdihi!

(Allahu i Madhëruar është i dëlirë nga të metat. Lartësoj lavdinë e Tij), i mbillet një pemë në Xhenet.”³²²

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم i tha sahabiut: “O Abdullah ibn Kajs! A të tregoj për një thesar të Xhenetit?”

- “Posi, o i Dërguari i Allahut” – i tha Ibn Kajsi. Profeti صلى الله عليه وسلم i tha: “Thuaj: ‘**Lā ḥawle we lā kuwwete il-lā bil-lāh.**’”³²³

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم ka thënë:

“Shprehjet më të dashura tek Allahu janë katër: “**Subhānall-Ilāh, welḥamdu lil-lāh, we lā ilāhe il-lall-Ilāh, wall-Ilāhu ekber.**” Nuk ka shumë rëndësi renditja e tyre.”³²⁴

Një nomad shkoi tek i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم dhe i tha: “Më mëso ca fjalë, që t’i përmend rregullisht”. Pejgamberi صلى الله عليه وسلم iu përgjigj: “Thuaj:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ.

³²¹Muslimi.

³²²Tirmidhiu dhe Hakimi (Sahih Xhami dhe Sahih Tirmidhi).

³²³Buhariu dhe Muslimi.

³²⁴Muslimi.

Lā ilāhe il-lal-Ilāhu waḥdehu lā sherīke lehu. All-Ilāhu ekberu kebīran, welḥamdu lil-lāhi kethīran, Subḥānall-Ilāhi rabbil ‘ālemīn, lā ḥawle we lā kuwwete il-lā bil-lāhil ‘Azīzil Ḥakīm.

(Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Allahut, Ai është i vetëm dhe i pashoq. Allahu është më i madhi. Lavdia e shumtë i takon Allahut. I Patëmetë është Allahu, Zoti i botëve. S’mund të bëhet asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për diçka veçse me vullnetin e Allahut, të Gjithëfuqishmit e të Urtit).

Nomadi tha: “Këto janë për të përmendur Zotit tim, po ç’lutje të bëj për veten? Pejgamberi صلی الله علیه وسلم iu përgjigj: “Thuaj:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَارْزُقْنِي.

All-Ilāhummeḡfir lī, werḥamnī, wehdinī, werzuḡnī.

(O Allah! Më fal, më mëshiro, më udhëzo dhe më furnizo!).”³²⁵

Kur dikush bëhej musliman, Pejgamberi صلی الله علیه وسلم i mësonte namazin, e pastaj e këshillonte të lutej me këto fjalë:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَعَافِنِي وَارْزُقْنِي.

All-Ilāhummeḡfir lī, werḥamnī, wehdinī, we ‘āfinī, werzuḡnī.

(O Allah! Më fal, më mëshiro, më udhëzo, më ruaj nga të këqijat dhe më furnizo).³²⁶

³²⁵Muslimi. Ebu Davudi sjell edhe këtë shtojcë: «Kur beduini u largua, Profeti صلی الله علیه وسلم tha: “I mbushi duart me mirësi (me bërjen e këtij dhikri dhe të kësaj lutjeje)”.

Lutja më e mirë është: **“Elḥamdu lil-lāh”**, kurse dhikri më i mirë është:

Lā ilāhe il-lall-llāh.”³²⁷

Fjalët më të mira, që u mbetet shpërblimi përgjithmonë, janë:

“Subḥānall-llāh, welḥamdu lil-lāh, we lā ilāhe il-lall-llāh, wall-llāhu ekber, we lā ḥawle we lā kuwwete il-lā bil-lāh”.³²⁸

131-SI E BËNTE DHIKRIN I DËRGUARI I ALLAHUT ﷺ

Abdullah ibn Amri رضي الله عنه tregon:

“Pashë Pejgamberin صلى الله عليه وسلم të numëronte dhikrin me dorën e djathtë.”³²⁹

³²⁶Muslimi. Në një transmetim tjetër po të Muslimit shtohet se Pejgamberi صلى الله عليه وسلم i tha: «Këto fjalë t'i përbmledhin çështjet e jetës tënde të dynjasë dhe të ahiretit».

³²⁷Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Hakimi (Sahihul Xhami).

³²⁸Ahmedi, Nesaiu, Ibn Hibani dhe Hakimi.

³²⁹Ebu Davudi dhe Tirmidhiu (Sahih Xhami).

132-DISA NORMA QË PËRFSHIJNË TË MIRAT E DYNJASË DHE TË AHIRETIT

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Kur të fillojë të erret, mbajini fëmijët të mos dalin nga shtëpia, sepse shejtanët (xhindët) përhapen në këtë kohë. Më pas, kur të kalojë njëfarë kohe prej natës, lërinie të dalin.

Mbyllini dyert, duke përmendur emrin e Allahut (*Bismilāh*), sepse shejtani nuk mund të hapë një derë të mbyllur. Lidhini grykat e calikëve, duke përmendur emrin e Allahut. Mbulojini enët, duke përmendur emrin e Allahut, qoftë edhe duke vendosur për së gjeri mbi enë diçka (si shkop etj.). Fikni kandilët (qirinjtë etj.).³³⁰

³³⁰Buhariu dhe Muslimi.

Fund

وَصَلَّى اللّٰهُ وَسَلَّم وَبَارَكَ عَلَى نَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِهِ وَأَصْحَابِهِ أَجْمَعِينَ.

We şal-lall-Ilāhu we sel-leme we bārake ‘ala nebijjina Muhammedin we ‘alā ālihi we aş-ḥābihi exhmeñn.

(Lavdërimi i Allahut, paqja dhe begatimi qofshin me Pejgamberin tonë Muhammedin, familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij).

PËRMBAJTJA

TABELA E TRANSLITERIMIT DHE SIMBOLEVE	3
FJALA E REDAKTORIT FETAR	5
HYRJA E AUTORIT	7
VLERA E PËRMENDJES SË ALLAHUT	9
1-DHIKRI SAPO ZGJOHEMI NGA GJUMI	13
2-KUR VESH RROBËN	16
3-KUR VESH NJË RROBË TË RE	17
4-LUTJA PËR DIKË TJETËR, QË KA VESHUR NJË RROBË TË RE	17
5-KUR ZHVESH RROBAT	18
6-KUR HYN NË TUALET.....	18
7-KUR DEL NGA TUALETI.....	18
8-DHIKRI PARA SE TË MARRËSH ABDES.....	19
9-DHIKRI PAS MBARIMIT TË ABDESIT	19
10-DHIKRI KUR DEL NGA SHTËPIA	20
11-DHIKRI KUR HYJMË NË SHTËPI.....	21
12-LUTJA QË THUHET KUR SHKON NË XHAMI	21
13-KUR HYJMË NË XHAMI.....	23
14-KUR DALIM NGA XHAMIA.....	24
15-KUR THIRRET EZANI	24
16-LUTJA PAS TEKBIT FILLESTAR, KUR HAPIM NAMAZIN	26
17-LUTJET NË RUKU	32
18-KUR NGRIHEMI NGA RUKUJA E NAMAZIT	33
19-LUTJET NË SEXHDE.....	35
20-LUTJA NË ULJEN NDËRMJET DY SEXHDEVE	37
21-LUTJET QË BËHEN NË SEXHDEN E LEXIMIT TË KURANIT.....	38
22-TEHIJATI GJATË TË NDEJURIT ULUR NË NAMAZ.....	39
23-SALAVATET PËR PROFETIN ﷺ PAS TEHIJATIT	40
24-LUTJA NË ULJEN E FUNDIT PARA SELAMIT	41
25-DHIKRI PAS SELAMIT.....	47
26-LUTJA E NAMAZIT TË <i>ISTIHARES</i>	53
27-DHIKRI I MËNGJESIT DHE I MBRËMJES	55
28-DHIKRI KUR BIEM NË GJUMË.....	69
29-NATËN, KUR LËVIZ NË SHTRAT NGA NJË ANË NË TJETRËN	78
30-KUR TREMBEMI NË GJUMË OSE KUR KEMI FRIKË NGA VETMIA	79
31-KUR SHEH ËNDËRR TË KEQE	79
32-LUTJA E <i>KUNUTIT</i> NË NAMAZIN E VITRIT.....	80
33-DHIKRI PAS SELAMIT NË NAMAZIN E VITRIT	82
34-LUTJA PËR LARGIMIN E ANKTHIT DHE TRISHTIMIT	82

35-LUTJA KUR JEMI NË GJENDJE SPROVE DHE MUNDIMI	84
36-LUTJA QË THEMI KUR PËRBALLEMI ME ARMIKUN DHE ME NJERIUN ME PUSHTET	85
37-KUR KEMI FRIKË NGA ZULLUMI I SUNDIMTARIT	86
38-LUTJA KUNDËR ARMIKUT	88
39-KUR KEMI FRIKË PREJ NJË GRUP NJERËZISH	88
40-KUR VUAJMË NGA NGACMIMI I DYSHIMIT NË BESIM	88
41-LUTJA PËR SHLYERJEN E BORXHEVE	89
42-KUR KEMI NGACMIME NGA SHEJTANI NË NAMAZ DHE GJATË LEXIMIT TË KURANIT	90
43-KUR NA VËSHITRËSOHEN ÇËSHTJET	91
44-KUR DIKUSH BËN NDONJË GJYNAH	91
45-PËR LARGIMIN E SHEJTANIT DHE VESVESEVE (NGACMIMEVE) TË TIJ ...	91
46-KUR NDODH DIÇKA QË NUK TË PËLQEN OSE KUR JE NË KUSHTE PAMUNDËSIE	92
47-URIMI PËR LINDJEN E NJË FËMIJE DHE PËRGJIGJJA	92
48-LUTJA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE	93
49-KUR VIZITOJMË TË SËMURIN	94
50-VLERA E VIZITËS SË TË SËMURIT	94
51-LUTJA E TË SËMURIT QË NUK KA MË SHPRESË PËR JETËN	95
52-TELKINI PËR NJERIUN NË PRAG TË VDEKJES	96
53-KUR DIKUJT I BIE NDONJË FATKEQËSI	96
54-KUR I MBYLL SYTË TË PORSVDEKURIT	97
55-LUTJA PËR TË VDEKURIN NË NAMAZIN E XHENAZES	97
56-LUTJA QË BËHET PËR FËMIJËN E VDEKUR, KUR I FALET NAMAZI I XHENAZES	100
57-LUTJA E NGUSHËLLIMIT	101
58-KUR I VDEKURI VENDOSËT NË VARR	102
59-PAS VARRIMIT	103
60-KUR VIZITOJMË VARREZAT	103
61-KUR FRYN ERË	104
62-KUR GJËMON	104
63-LUTJET PËR TË RËNË SHI	105
(LUTJA E <i>ISTISKASË</i>)	105
64-KUR BIE SHI	106
65-PAS RESHJEVE TË SHIUT	106
66-LUTJET PËR KTHJELLIMIN E MOTIT	106
67-KUR SHOHIM HËNËZËN E RE	107
68-KUR ÇELIM IFTAR	107
69-PARA USHQIMIT	108

70-PAS NGRËNIES SË USHQIMIT	109
71-LUTJA QË BËN MIKU PËR TË ZOTIN E USHQIMIT	110
72-KËRKIMI I USHQIMIT OSE PIJES, TËRTHORAZI, NËPËRMJET LUTJES	110
73-KUR ÇELIM IFTARIN SI TË FTUAR	111
74-LUTJA QË BËN AGJËRUESI, NËSE NUK E PRISH AGJËRIMIN, KUR E FTOJNË PËR TË NGRËNË.....	111
75-PËRGJIGJJA QË JEP AGJËRUESI KUR DIKUSH E FYEN	111
76-KUR SHOHIM FRUTAT E PARA TË PJEKURA	112
77-KUR TESHTIJMË	112
78-KUR NJË JOBESIMTAR TESHTIN DHE THOTË ‘ELĤAMDU LIL-LĤH!’	113
79-LUTJA PËR TË SAPOMARTUARIN	113
80-LUTJA QË BËN I PORSAMARTUARI PËR VETVETEN, DHE LUTJA QË BËHET NË RASTIN E BLERJES SË KAFSHËS	114
81-LUTJA PËRPARA SE TË KRYHEN MARRËDHËNIE INTIME	114
82-KUR NEVRIKOSEMI	115
83-KUR SHOHIM NJË PERSON TË SPROVUAR ME SËMUNDJE, TË METË FIZIKE A MENDORE, GJYMTIM OSE GJYNAH.....	115
84-GJATË KUVENDIT	115
85-LUTJA PËR SHLYERJEN E GJYNAHEVE, KUR MBARON TAKIMI A KUVENDI	116
86-KUR DIKUSH TË THOTË: “ALLAHU TË FALTË”	116
87-LUTJA PËR DIKË, QË TË BËN NDONJË TË MIRË	116
88-PËR TË NA RUAJTUR ALLAHU PREJ DEXHALIT	117
89-PËR DIKË, QË TË THOTË «INNĬ UĤIBUKE FIL-LAH – TË DUA PËR HIR TË ALLAHUT»	117
90-PËR DIKË, QË DËSHIRON TË TË FALË PASURI	117
91-KUR I KTHEJMË BORXHIN HUADHËNËSIT	118
92-LUTJA E FRIKËS NGA SHIRKU	118
93-LUTJA PËR DIKË, QË TË THOTË: “BĤRAKALL-LLĤHU FĬKE – ALLAHU TË BEGATOFTË”	118
94-KUR PARANDJEN DIÇKA TË URRYER NGA NJË SHENJË BESËTYTNORE (OGURZEŽË)	119
95-LUTJA KUR HIPIM NË MJETIN E UDHËTIMIT	119
96-LUTJA E UDHËTIMIT	120
97-LUTJA KUR HYJMË NË NJË QYTET OSE VENDBANIM	122
98-LUTJA KUR HYJMË NË TREG	123
99-KUR KAFSHA E UDHËTIMIT PENGOHET	123
100-LUTJA E UDHËTARIT PËR NJERËZIT, KUR NDAHET ME TA PËR UDHËTIM	123
101-LUTJA PËR UDHËTARIN KUR NISËT PËR UDHËTIM	124

102-THËNIA ALLÃHU EKBER DHE SUBHÃN-ALLÃH GJATË ECJES NË UDHËTIM	124
103-LUTJA QË BËN UDHËTARI NGA FUNDI I NATËS, PAK PARA AGIMIT ..	125
104-LUTJA KUR QËNDROJMË DIKU NË NJË VEND, QOFSHIM UDHËTARË APO JO	125
105-DHIKRI GJATË KTHIMIT NGA UDHËTIMI	126
106-KUR NA VJEN DIÇKA QË NA GËZON OSE DIÇKA QË NUK NA PËLQEN	127
107-MIRËSIA QË KEMI, KUR BËJMË ‘SALAVAT’ PËR PEJGAMBERIN ﷺ ..	127
108-PËRSHËNDETJA ME SELAM.....	128
109-KUR NJË JOMUSLIMAN NA JEP SELAM	129
110-KUR DËGJON KËNDIMIN E GJELIT DHE PËLLITJEN E GOMARIT	129
111-LUTJA KUR DËGJOJMË QENTË DUKE LEHUR NATËN	130
112-LUTJA QË BËN PËR DIKË, QË MUND TA KESH OFENDUAR.....	130
113-FJALËT QË DUHET TË THUASH KUR LAVDËRON NJË MUSLIMAN	131
114-LUTJA QË BËN MUSLIMANI KUR DIKUSH E LAVDËRON	131
115-SI BËJMË TELBIJE KUR JEMI NË GJENDJE IHRAMI PËR HAXH OSE UMRE	132
116-KUR FILLON TAVAFIN TE KËNDI I GURIT TË ZI, DHE SA HERË QË FILLON XHIROT E TAVAFIT ATY, BËN TEKBIRE	132
117-LUTJA KUR KALON MES KËNDIT TË JEMENIT DHE GURIT TË ZI	133
118-LUTJA KUR QËNDRON MBI SAFA DHE MBI MERVE	133
119-LUTJA E DITËS SË ARAFATIT	134
120-DHIKRI QË BËHET NË MESH’AR EL HARAM	135
121-KUR HEDHIM GURËT TE XHEMERATET, ÇDO GUR E SHOQËROJMË ME TEKBIR	135
122-KUR SHPREHIM HABI DHE KUR DIÇKA NA GËZON	136
123-KUR NA VJEN NJË LAJM I GËZUESHËM	136
124-KUR NDIEN DHIMBJE NË TRUP	136
125-KUR NDONJËRI KA FRIKË SE MERR DIÇKA MËSYSH	137
126-KUR TREMBEMI NGA DIÇKA	137
127-KUR THERIM NJË BAGËTI	138
128-LUTJA QË THUHET PËR LARGIMIN E KURTHIT TË SHEJTANËVE MË TË KËQIJ	138
129-KËRKIMI I FALJES (ISTIGFARI) DHE PENDIMI (TEUBEJA)	139
130-MIRËSIA QË KEMI KUR THEMI:	140
131-SI E BËNTE DHIKRIN I DËRGUARI I ALLAHUT ﷺ	144
132-DISA NORMA QË PËRFSHIJNË TË MIRAT E DYNJASË DHE TË AHIRETIT	145